



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

**“Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”.**

**Tiranë 2024**

## P Ë R M B A J T J A

<b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</b> .....	1
<b>1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT</b> .....	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	6
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	7
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	7
<b>2. SUBJEKTET NËN AUDITIM</b> .....	8
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	8
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	9
Kriteret politike:.....	9
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	10
2.4 Peshë në buxhet.....	12
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	14
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	16
2.7 Feedback-u i subjektit.....	17
<b>3. DETAJET E AUDITIMIT</b> .....	17
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	17
3.2 Objektivi i auditimit.....	18
3.3 Pyetjet e auditimit.....	18
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	18
<b>4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE</b> .....	19
4.1 Si është situata e menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?.....	19
4.1.1 A i ka shërbyer skema e organizimit të menaxhimit të mbetjeve, optimizimit të kostove të tyre në bashkitë nën auditim?.....	19
4.1.2 A mbulojnë Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e përfituara prej tyre?.....	34
4.2 A është hartuar dhe zbatuar baza ligjore e nënligjore për menaxhimin e mbetjeve urbane nga bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?.....	40
4.2.2 A kanë vendosur dhe zbatuar bashkitë objektivat e duhura në funksion të kuadrit ligjor? ....	45
<b>5. GRUPI I PUNËS</b> .....	51

## AKRONIMET

<b>RSH</b>	Republika e Shqipërisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MTM</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>NJVQV</b>	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
<b>VKM</b>	Vendimi i Këshillit të Ministrave
<b>VKB</b>	Vendimi i Këshillit Bashkiak
<b>INTOSAI</b>	The International Organization of Supreme Audit Institutions
<b>EUROSAI</b>	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
<b>US EPA</b>	United States Environment Protection Agency
<b>ISSAI</b>	International Standards of Supreme Audit Institutions
<b>VSM</b>	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

## PËRMBLEDHJA

Auditimi me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë” ka pasur si objekt kryesor vlerësimin e masave të marra nga bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë mbi mënyrën e menaxhimit të mbetjeve urbane, ndikimin që ato kanë në buxhetin e shtetit si dhe impaktin në shëndetin e popullatës dhe mjedisit rrethues. Periudha objekt auditimi ka qenë 2020-2023.

Menaxhimi i mbetjeve është gjithmonë një nga problemet kryesore që duhet të jetë në vëmendje të bashkive për arsye të ndikimit në mjedis, shëndetin publik, aspekteve financiare, legjislacionit të ndërlikuar, etj. Sfidat kryesore të menaxhimit të integruar të mbetjeve janë:

- *Volumi i mbetjeve:* Me ndryshimin e popullsisë dhe zhvillimin urban, volumi i mbetjeve po rritet;
- *Ndërtimi i infrastrukturës:* Ndërtimi i infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve kërkon investime të mëdha financiare dhe koordinim të qeverisë lokale dhe qendrore;
- *Ndikimi në mjedis:* Menaxhimi i gabuar i mbetjeve ka ndikim të konsiderueshëm negativ në mjedis, duke përfshirë ndotjen e ajrit, ujërave dhe tokës;
- *Legjislacioni dhe rregullimet:* Rregullimet e ndryshme ligjore dhe teknike për menaxhimin e mbetjeve shpesh janë të ndërlikuara dhe të ndryshueshme;
- *Ndërgjegjësimi i publikut:* Fushat e përhershme të informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut janë sfida për të ndihmuar në ndryshimin e sjelljeve të konsumatorëve në trajtimin e mbetjeve.

Në këtë drejtim këto bashki nuk kanë siguruar menaxhim të integruar të mbetjeve urbane të prodhuara në territorin e tyre. Pra, në skemë e menaxhimit aktual të mbetjeve urbane që ato arrijnë të sigurojnë nuk realizohen proceset thelbësore si parandalimi, ripërdorimi, reduktimi e riciklimi i tyre. Gjithashtu, menaxhimi aktual i mbetjeve urbane nuk ka nxitur minimizimin e kostove të menaxhimit të mbetjeve për të përfituar edhe të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre.

Më konkretisht, Bashkia Durrës gjatë menaxhimit të mbetjeve urbane nuk garanton qëndrueshmëri financiare të këtij procesi, pasi të ardhurat e krijuara për këtë qëllim nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet. Kjo situatë vjen si rrjedhojë e faktit se, Bashkia Durrës nuk ka arritur të mbledhë të gjitha të ardhurat e planifikuara nga tarifa e pastrimit. Megjithatë edhe nëse do të arrihej mbledhja e tyre në nivelin 100 %, përsëri nuk do të mund të mbulohehin shpenzimet totale për menaxhimin e mbetjeve urbane në këtë bashki. Arsyja kryesore e mos mbulimit të shpenzimeve është ndryshimi i venddepozitimit të tyre në landifillin e Sharrës. Kjo gjë ka rritur ndjeshëm peshën që zë menaxhimi i mbetjeve në buxhetin total të bashkisë. Rreth 1/3 ose rreth 30 % e buxhetit të Bashkisë së Durrësit shkon për menaxhimin e mbetjeve urbane, ndërkohë që referuar Kombeve të Bashkuara ky tregues duhet të jetë në nivelet 3-15 %.

Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë paraqet problematika të tjera edhe më të rënda. Në këtë bashki mbetjet urbane depozitohen në një fushë të depozitimi e cila nuk respekton asnjë kriter mjedisor. Mbetjet urbane digjen në mjedis të hapur duke shkaktuar problematika të rëndësishme në shëndet dhe mjedis që vijnë nga çlirimi i dioksinave dhe furaneve në mjedis. Ekspozimi ndaj dioksinave, furaneve etj., shkakton lloje të ndryshme të kancerit, probleme të mëlçisë, dëmtime të sistemit imunitar, sistemit endokrin dhe funksioneve riprodhuese si dhe efekte negative në zhvillimin e sistemit nervor. Kjo situatë ka sjellë edhe pasoja ekonomike duke ndikuar në zhvlerësimin e pronave në afërsi të fushës së vend depozitimit të mbetjeve urbane në qytetin e Vlorës. Një tjetër çështje e trajtuar është edhe mënyra e përlogaritjes së tarifës së pastrimit për të cilën bashkitë subjekt auditimi, nuk marrin në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën familja jeton. Gjithashtu edhe për tarifën e vendosura për biznesin, ato nuk marrin në konsideratë sipërfaqen në të cilin biznesi ushtron aktivitetin e tij. Marrja në konsideratë e madhësisë së familjes si dhe sipërfaqes së banimit dhe ushtrimit të aktivitetit (në rastin e bizneseve)

do ta bënte më të drejtë tarifën që çdo abonent do të duhet të paguajë. Sa i përket zbatimit të politikave dhe kuadrit ligjor në fuqi, bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore lidhur me procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor duke qenë se nuk i kanë shoqëruar Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane me VSM. Gjithashtu, ato nuk kanë raportuar periodikisht në Këshillat e Qarqeve mbi zbatimin e planeve vendore, nuk kanë arritur objektivat mbi grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime kompostimi si dhe riciklimin e letrës, kartonit, qelqit dhe plastikës.

Për të gjitha çështjet e mësipërme, janë dhënë rekomandime në drejtim të përmirësimit të shkaqeve që çojnë në këto mangësi me qëllim eliminimin dhe zbutjen e ndikimeve negative që këto problematika kanë në ekonomi, mjedis dhe shëndetin e popullatës.

# 1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

## 1.1 Konteksti i problemit social

Mbeturinat nuk janë vetëm gjëra që ne nuk na nevojiten më, as gjëra që na mbesin nga prodhimi i mallrave të ndryshme. Ato janë edhe gjëra me të cilat ne mund të përfitojmë. Eliminimi i mbetjeve urbane përbën një hallkë jetike në konceptin fillim-përfundim të menaxhimit të mbetjeve urbane. Theksi i tanishëm mbi parandalimin e ndotjes si dhe zhvillimi i teknologjive të trajtimit ka si rezultat pakësimin e volumit të mbetjeve urbane të cilat duhet të eliminohen. Të gjithë prodhojnë mbetje. Parandalimi i mbetjeve duhet të jetë një element kyç i politikave të integruara.

Problemet me heqjen apo menaxhimin e mbetjeve siç quhet sot e kanë shoqëruar njeriun gjatë gjithë historisë së njerëzimit. Shumë dokumente të vjetër raportojnë hedhjen e mbeturinave në rrugë gjatë shekujve të kaluar. Mungesa e një plani të menaxhimit të mbetjeve në qytete dhe komunitete të ndryshme në Evropë kanë pasur pasoja të konsiderueshme në mirëqenien e njerëzve. Modeli i jetës moderne, si ambalazhimi i mallrave dhe përdorimi i mjeteve elektronike ka ndryshuar përbërjen e mbetjeve përgjatë shekujve. Kjo do të thotë se zgjidhjet në menaxhimin e mbetjeve urbane duhet të marrin në konsideratë evoluimin e njerëzimit dhe trendet e konsumimit bashkëkohor. Qëkur lëvizjet e para mjedisore u shfaqën në vitet 1960, shumica e mbetjeve asgjësoheshin me pak ose aspak kontroll në tokë, thjesht duke i depozituar në një vendgrumbullim (*dump*) të hapur në ajër, duke i djegur ose duke avulluar përbërësit e paqëndrueshëm; ose në ujë, duke shkarkuar mbetjet e ngurta ose të lëngshme në ujëra sipërfaqësore, nëntokësore, dete e oqeanë. Nuk tregohet aspak kujdes për efektet në burimet ujore dhe shëndetin banorëve që jetonin afër. Filozofia që mbizotëronte ishte “larg të parit, larg mendjes” – *out of sight out of mind*. Gjatë 30 - 40 viteve të fundit, qytetet kanë kërkuar gjithmonë e më shumë të marrin kontrollin e sasive në rritje të mbeturinave për të ruajtur një mjedis të pastër.<sup>1</sup>

Pavarësisht nga konteksti, menaxhimi i mbetjeve të ngurta është një nga sfidat më të mëdha të zonave urbane të të gjitha madhësive. Menaxhimi i mbetjeve është pothuajse gjithmonë në pesë problemet kryesore dhe më sfiduese për kryetarët e bashkive. Cilësia e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve është një tregues i mirë i qeverisjes së një qyteti. Mënyra në të cilën mbetjet prodhohen dhe administrohen, na jep një pasqyrë të rëndësishme se si njerëzit jetojnë. Në fakt, nëse një qytet është i pisët, administrata lokale mund të konsiderohet joefektive ose banorët e saj mund të “akuzohen” për hedhjen e mbeturinave. Të dhënat e disponueshme tregojnë se qytetet shpenzojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të tyre aktual në dispozicion. Megjithatë, normat e grumbullimit të mbetjeve (për qytetet në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme) variojnë nga niveli i ulët prej 10 për qind në zonat sub-urbane deri në 90 për qind në qendrat e qyteteve.<sup>2</sup>

Përkufizimet e mbetjeve urbane ndryshojnë midis vendeve. Përkufizimi i mbetjeve është: “çdo lloj material, i ngurtë, të lëngshëm ose i gaztë, që hidhen poshtë dhe janë të padëshiruara nga njerëzit”. Mbetjet e ngurta janë material që nuk janë në formë të lëngshme ose të gaztë. Megjithatë me mbetje urbane kuptojmë mbetjet e krijuara nga familjet, mbetjet e ngjashme të krijuara nga objektet komerciale ose nga institucione të tilla si shkolla, spitale, burgje, shtëpitë sociale ose dhe nga hapësirat publike siç janë rrugët, tregjet, stacionet e autobusëve, parqet, dhe kopshtet. Ky përkufizim i mbetjeve urbane përfshin shumicën e mbetjeve komerciale dhe të biznesit me përjashtim të mbetjeve industriale dhe ato të rrezikshme.<sup>3</sup>

Menaxhimi i duhur i mbetjeve mund të çojë në një përmirësim të përdorimit të burimeve pasi mbetjet urbane mund të jenë burim i lëndëve të para. Letra, kartoni, metalet, qelqi dhe plastika

<sup>1</sup> Solid waste management in the world cities, United Nations Human Settlements Programme, 2010, fq XX.

<sup>2</sup> Solid waste management in the world cities, United Nations Human Settlements Programme, 2010, fq V.

<sup>3</sup> Solid waste management in the world cities, United Nations Human Settlements Programme, 2010, fq 6.

mund të riciklohen dhe mbetjet e biodegradueshme të shndërrohen në kompost të pasur me lëndë ushqyese për t'u përdorur në bujqësi si një përmirësues i tokës. Ajo që mbetet mund të digjet/incenerohet (rikuperimi i energjisë) ose të hidhet në lëndfill. Mbetjet urbane, nëse nuk grumbullohen, trajtohen dhe asgjësohen në mënyrën e duhur mund të kthehen në kërcënim serioz për shëndetin e njerëzve dhe mund të shkaktojnë ndikime mjedisore negative në ajër (nga emetimi i gazeve serë), në tokë (nëpërmjet lëngut kullues ose “leachate” siç quhet në gjuhën ndërkombëtare si rezultat i vendgrumbullimeve ilegale të mbetjeve ose mos funksionimit brenda standardeve të lëndfill-eve), në ujë (nëpërmjet ujërave të shiut që bien në kontakt me mbetjet dhe precipitojnë në ujërat nëntokësore ose sipërfaqësore), si dhe probleme me aromën dhe ndotjen e ajrit.<sup>4</sup> Djegia e mbeturinave në ambient të hapur prodhon shumë ndotës të rrezikshëm për shëndetin e njeriut të cilat do t'i trajtojmë edhe në vijim si për shembull dioksina, hidrokarbure aromatike policiklike, përbërës organikë të paqëndrueshëm (VOC), oksid karboni, heksaklorobenzen dhe hiri.<sup>5</sup> Djegia e mbetjeve urbane në Bashkinë e Vlorës<sup>6</sup> është edhe një nga arsyet kryesore të iniciimit të këtij auditimi. Të gjithë jemi dëshmitarë që veçanërisht verën e kaluar, situata në vendgrumbullimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Vlorë ishte tejet problematike. Përfshirja edhe e Bashkive të Korçës, Durrësit dhe Shkodrës (të cilat kanë ngjashmëri me Bashkinë e Vlorës sa i përket karakteristikave të tyre) pavarësisht se sot mund të mos kenë probleme me djegien e mbetjeve është një mundësi e mirë për krahasimin e tyre me njëra tjetrën por njëkohësisht edhe përmirësimin e situatës në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

## 1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkitë Durrës, Vlorë, Shkodër e Korçë si dhe ndikimeve ekonomike, sociale e mjedisore në territorin e këtyre bashkive.

## 1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

K Kontrolli i Lartë i Shtetit në veprimtarinë e tij audituese, gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve vendore sa i përket administrimit menaxhimit të mbetjeve urbane me qëllim optimizimin e parasë publike për të kryer këtë shërbim. Lidhur me tematika të ngjashme, KLSH ka kryer:

- Auditimin e performancës me temë “Pastrimi i qytetit” bazuar në programin e auditimit nr. 645/3 prot., datë 01.10.2020, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.112, datë 15/09/2021. Ky auditim u ushtrua në Bashkinë e Vlorës.

<sup>4</sup> European Courts of Auditors, Special Report No 20 2012, paragraph 2 & 3, <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/6661759d-174c-4c56-96ec-2132a0448b0a/language-en>

<sup>5</sup> US EPA - <https://archive.epa.gov/epawaste/nonhaz/municipal/web/html/health.html>

<sup>6</sup> <https://shqiptarja.com/lajm/zjarr-ne-fushen-e-grumbullimit-te-mbetjeve-ne-vlore-tymi-pushton-zonen-zjarrefikset-po-punojne-per-shuarjen-e-flakeve>

- Auditimin e performancës me temë: “Menaxhimi i mbetjeve plastike” bazuar në programin e auditimit nr. 202/4 prot., datë 19.04.2021, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 122, datë 21.09.2021. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkinë Tiranë, Bashkinë Vlorë dhe Bashkinë Elbasan.
- Auditimin e performancës me temë: “Incineratori i Tiranës” bazuar në programin e auditimit nr. 1142/18 prot., datë 10.05.2021, i cili konkludoi me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 111, datë 01.07.2022. Ky auditim u ushtrua në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkinë Tiranë.

## 2. SUBJEKTET NËN AUDITIM

### 2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Bashkia Durrës
2. Bashkia Shkodër
3. Bashkia Vlorë
4. Bashkia Korçë

Pas Bashkisë së Tiranës (për të cilën në vitet e fundit janë kryer dy auditime performance lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane), bashkitë e Durrësit, Vlorës, Korçës dhe Shkodrës janë nga më të rëndësishme në rang vendi sa i përket potencialit ekonomik, turistik, historik etj. Këto bashki presin me mijëra turistë në vit, ndaj edhe menaxhimi i mbetjeve urbane merr një rëndësi të veçantë në këto bashki duke qenë se ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në turizëm dhe ekonomi. Nga ana tjetër një situatë tejet emergjente dhe problematike paraqitet në Bashkinë e Vlorë në vitet e fundit ku vendgrumbullimi i mbetjeve urbane (veçanërisht në verë) digjet duke shkaktuar helme toksike për komunitetin që jeton aty pranë.<sup>7</sup> Duke qenë se auditimet e performancës synojnë përmirësimin e situatës përtej kuadrit ligjor dhe rregullator duke përdorur metodën e krahasimit ose “benchmarking”, është menduar që krahasimi i këtyre katër bashkive me tipologji të ngjashme sa i përket gjeografisë, ekonomisë, turizmit, historisë që ato përfaqësojnë etj., do të shërbejë për të evidentuar shembuj e praktika të mira jo vetëm midis tyre por edhe nga praktika të mira ndërkombëtare.

Roli i këtyre 4 bashkive subjekt auditimi, ashtu si edhe të gjitha bashkive të tjera në vend, sa i përket menaxhimit të mbetjeve, është përcaktuar nga Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Forcimi i rolit të bashkive është një domosdoshmëri, e cila rrjedh nga harmonizimi i Ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” me dispozitat e ligjit, “Për vetëqeverisjen vendore”. Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve bashkiake, të cilat mblihen nga/ose për llogari të bashkive dhe përfshijnë:

- mbetjet shtëpiake dhe të ngjashme; përfshirë
- mbetjet e vëllimshme, p.sh., mobilie të vjetra;
- mbetjet e kopshteve, gjethet, prerjet e pemëve nga krasitjet, mbetjet nga pastrimi i rrugëve dhe i tregjeve publike;
- mbetjet nga aktivitetet tregtare dhe bizneset e vogla, zyrat dhe institucionet;
- mbetjet nga shërbime të tjera bashkiake, si parqet, lulishtet etj.

Bashkitë janë kryesisht përgjegjëse për operimin e shërbimit të pastrimit, mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në pikat e grumbullimit (stacionet e transferimit). Bashkitë mund të ngrenë dhe të operojnë qendra me interes vendor për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, përfshirë mbetjet e vëllimshme, mbetjet e riciklueshme dhe mbetjet e biodegradueshme. Ndarja në burim është përgjegjësi e NJVQV-së. Sistemet e riciklimit për ambalazhet dhe për mbetje të tjera

<sup>7</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=ZnL9gVb5Vlo>



specifike duhet të ngrihen nga prodhuesit e produkteve dhe/ose industrinë e riciklimit nën skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit.

Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, rregullon organizimin dhe funksionimin e njësisë të qeverisjes vendore dhe të organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre. Në mënyrë të veçantë, “grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake” është përcaktuar si një funksion “i veti” i bashkive. Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi, për:

- organizimin për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve bashkiake;
- ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit;
- vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhjen e të ardhurave;
- organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vetë bashkinë dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjitha instrumentet ligjore dhe administrative.<sup>8</sup>

Metodat dhe teknologjitë që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave, caktohen nga bashkitë dhe komunat, në bashkëpunim me organet kompetente. Bashkitë gjithashtu kanë të drejtë të mbikëqyrin dhe kontrollojnë pastrimin dhe largimin e mbeturinave në raste kur këto shërbime kryhen nga operatorë privatë. Bashkitë gjithashtu janë të pavarura në përcaktimin e tarifave të pastrimit që duhet të mbulojnë shërbimin e të gjithë menaxhimit të mbetjeve urbane. Tarifat e pastrimit caktohen duke pasur parasysh teknikën dhe teknologjinë e përdorur, koston, numrin e kontejnerëve dhe kushte të tjera.<sup>9</sup>

## **2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim**

### **Kriteret politike:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”;
- Vendim i Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, Datë 13.01.2020, Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

### **Akte ligjore e nënligjore**

- Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Ligji nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Ligji nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”;
- VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Shkodër nr. 83 datë 26.12.2017 “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane Bashkia 2017-2022”;
- VKM nr. 319, date 31.05.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”
- Vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Korçë nr. 83 datë 26.12.2017 “Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Korçë 2023-2028”;

---

<sup>8</sup> VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, pika 6.2.7.

<sup>9</sup> Ligji nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”;

- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr. 994 datë 30.08.2023 “Mbi miratimin dhe zbatimin e procedurës standard të veprimit për administrimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit për Bashkinë Shkodër”;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vlorë nr. 36 datë 28.03.2019 “Për ngritjen e ndërmarrjes publike bashkiake për menaxhimin e mbetjeve urbane për Bashkinë Vlorë”.

### **Praktika të mira ndërkombëtare**

- European Courts of Auditors, Special Report No 20, 2012, Is structural measures funding for municipal waste management infrastructure projects effective in helping member states achieve EU waste policy objectives?;
- SAI of Lithuania, Municipal Waste Management, 2017;
- Solid waste management in the world cities, United Nations Human Settlements Programme, 2010;
- European Commission, Guidance for separate collection of municipal waste, 2020.

### **2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit**

Dokumenti i politikave strategjike të menaxhimit të mbetjeve dhe Plani Kombëtar për Menaxhimin e mbetjeve i miratuar me VKM nr. 418 datë 27.05.2020 është një nga dokumentet më të rëndësishme dhe thelbësore në fushën e mbetjeve, që synon kalimin nga ekonomia lineare në atë qarkulluese. Ai është dokumenti kryesor planifikues në fushën e menaxhimit të mbetjeve bashkiake në Shqipëri dhe mbulon periudhën kohore 2020–2035. Ky dokument do të shërbejë si mekanizëm që do të ndërlidhë gjithë aktorët dhe operatorët që përfshihen në këtë cikël, me qëllim përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në shëndetin e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.<sup>10</sup>

Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta i miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.1, Datë 13.01.2020, përfaqëson dokumentin e nivelit të dytë të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve i cili përcakton kuadrin planifikues, lidhur me investimet në infrastrukturën, në nivel kombëtar dhe atë të zonave të menaxhimit të mbetjeve. Plani kombëtar sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta duhet të orientohet drejt:

- identifikimit dhe përcaktimit të metodologjisë dhe teknologjisë për investimet e ardhshme për trajtimin e mbetjeve për sistemin e integruar të menaxhimit të mbetjeve, duke përfshirë pajisjet për grumbullimin e mbetjeve, kompostimin, riciklimin, djegien për rikuperim energjie dhe depozitimin mbi bazën e zonave të menaxhimit të mbetjeve;
- përcaktimit të kostove dhe të tarifave lidhur me depozitimin e mbetjeve në impiantet e trajtimit dhe stacionet e transferimit të mbetjeve;
- një sistemi objektiv të verifikueshëm dhe transparent të prioritetëve të investimeve të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve që ndërtohet në bazë të vlerësimit të nevojave dhe të ndikimeve.<sup>11</sup>

Referuar Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, në Shqipëri mbetjet organike përbëjnë mesatarisht 47-50 % të totalit të mbetjeve. Sigurisht, kjo përqindje mund të ndryshojë në varësi të karakteristikave të qytetit/zonës ku zonat rurale priren të gjenerojnë më shumë mbetje organike se zonat urbane. Rreth 34 % e totalit të mbetjeve përbëhet nga mbetje të riciklueshme (letër dhe karton 14 %, plastikë 13 %, metal 1 % dhe qelq 6 %).

<sup>10</sup> VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, fq. 4


<sup>11</sup> VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e dokumentit të politikave strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, fq. 10

Tabela 1 Përqindja mesatare e rrymave të mbetjeve, 2019

Rryma e Mbetjeve	Mesatarja Kombëtare [%]	Rryma e Mbetjeve	Mesatarja Kombëtare [%]
Organike	47.36	Metale (pa ngjyra)	0.57
Dru	1.43	Produkte spitalore	0.17
Letër	5.37	Produkte gome	0.2
Karton	8.13	Inerte	7.2
Plastikë LD	8.46	Mbetje sanpro	3.25
Plastikë HD	4.75	MPEE	0.31
Qelq	5.75	Bateri	0.02
Tekstile	5.27	Nën produkte shtazore	1.08
Metale (me ngjyra)	0.56		

Burimi: Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, fq 34

Grafik 1. Përqindja mesatare e rrymave kryesore të mbetjeve, 2019



Burimi: Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, fq 34

Çdo njësi e qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar. Të gjitha subjektet nën këtë auditim, kanë miratuar Planet Vendore të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane. Konkretisht:

- Bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar “Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për periudhën 2017-2022”;<sup>12</sup>
- Bashkia Durrës ka hartuar “Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për Bashkinë e Durrësit për periudhën 2010-2025”<sup>13</sup>
- Bashkia Vlorë ka hartuar “Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Vlorë për periudhën 2023-2028”<sup>14</sup>
- Bashkia Korçë me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 83 datë 26.12.2017 ka miratuar “Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Korçë 2023-2028”;

<sup>12</sup> <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/07/Plani-i-menxhimit-te-integruar-te-mbetjeve-te-ngurta-2017-2022.pdf>

<sup>13</sup> <https://durrës.gov.al/ngarkime/uploads/2014/06/BASHKIADURRES.pdf>

<sup>14</sup> <https://konsultimivendor.al/wp-content/uploads/2023/04/PVMIM-Vlore-30.03.2023.pdf>

Këto plane përveç se janë detyrime të politikave dhe kuadrit ligjor mbi menaxhimin e mbetjeve, janë të orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit, trajtimit final dhe impianteve respektive të trajtimit të mbetjeve. Ndaj edhe grupi i auditimit, në vazhdimësi të këtij auditimi do të fokusohet edhe në realizmin e masave apo objektivave të vendosura në këto plane.

## 2.4 Pesha në buxhet

Në mënyrë narrative për secilin subjekt auditimi është paraqitur buxheti total i çdo bashkie dhe buxheti i mbetjeve i ndarë për proceset kryesore lidhur me menaxhimin e mbetjeve që kryhet në këto bashki. Në vijim të auditimit, shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve nga ana e bashkive subjekt auditimi do të analizohen edhe më të detajuara mbi shkaqet dhe arsyet kryesore që ndikojnë në koston totale që bashkitë duhet të kryejnë për të mbuluar shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

### ***Bashkia Durrës***

Siç vihet re edhe nga tabela nr. 2, buxheti total i Bashkisë Durrës ka ardhur në rritje nga viti 2020 me rreth 2.4 miliardë lekë në rreth 3.9 miliardë lekë në vitin 2023. Në rritje paraqiten edhe shpenzimet mbi menaxhimin e mbetjeve urbane ku për vitin 2020 janë shpenzuar rreth 370 milionë lekë ndërsa për vitin 2022 e 2023 respektivisht rreth 964 milionë lekë dhe 961 milionë lekë.

Tab 2. Buxheti i Bashkisë Durrës dhe i mbetjeve urbane

mijë lekë

<b>Bashkia Durrës</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Buxheti (fakt) total i Bashkisë	2,432,953	2,521,669	3,284,100	3,945,205
Buxheti (fakt) i menaxhimit të mbetjeve	370,153	437,426	964,074	961,564
Raporti i buxhetit të mbetjeve me buxhetin total (%)	15.2	17.3	29.3	24.3

Burimi: Bashkia Durrës

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në tabelën nr. 3 shpenzimet mbi menaxhimin e mbetjeve janë ndarë sipas proceseve kryesore. Grumbullimi së bashku me pastrimin dhe transportin janë konsideruar një proces më vete dhe shpenzimet mbi këtë proces janë rritur nga viti në vit nga rreth 370 milionë lekë në 2020 në rreth 665 milionë lekë në 2023. Ndërsa sa i përket shpenzimeve mbi depozitimin në lëndfill, (kujtojmë se bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 68 datë 10.06.2021 “Për miratimin e skenarit të menaxhimit të mbetjeve, bazuar në Vendimin nr. 6 datë 20.05.2021 të komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimin nr. 3, datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut Durrës”, Bashkia Durrës, që prej 2021 i depoziton mbetjet në lëndfillin e Sharrës), për vitin 2022 janë shpenzuar rreth 279 milionë lekë, ndërsa për vitin 2023 rreth 295 milionë lekë.

Tab. 3 Buxheti i mbetjeve i Bashkisë Durrës (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)

mijë lekë

	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Grumbullim, transport, pastrim	370,153	421,940	684,960	665,980
Depozitimi në lëndfill		15,486	279,114	295,584
Totali i buxhetit të mbetjeve	370,153	437,426	964,074	961,564

Burimi: Bashkia Durrës

Përpunoi: Grupi i auditimit

### ***Bashkia Shkodër***

Buxheti total i Bashkisë Shkodër për vitin 2020 ka qenë rreth 2.77 miliardë lekë duke pësuar një rritje të lehtë në vitin 2021 dhe 2022 respektivisht me 2.79 dhe 2.95 miliardë lekë. Gjithashtu, edhe shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane kanë ardhur në rritje gjatë këtyre viteve, konkretisht nga 131.5 milionë lekë në vitin 2020 në 183.1 milionë lekë në vitin 2022.

Tab 4. Buxheti i Bashkisë Shkodër dhe i mbetjeje urbane

mijë lekë

<b>Bashkia Shkodër</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Buxheti (fakt) total i Bashkisë	2,774,974	2,792,779	2,950,182	2,543,914
Buxheti (fakt) i menaxhimit të mbetjeje	131,593	121,313	183,173	187,659
Raporti i buxhetit të mbetjeje me buxhetin total (%)	4.74	4.34	6.2	7.3

Burimi: Bashkia Shkodër

Përpunoi: Grupi i auditimit

Sa i përket proceseve kryesore të menaxhimit të mbetjeje urbane në Bashkinë Shkodër, gjatë vitit 2020 janë shpenzuar rreth 97 milionë lekë për grumbullimin dhe transportin dhe rreth 34 milionë lekë për depozitimin e tyre në lëndfillin e Bushatit. Shpenzimet për depozitimin në lëndfillin e Bushatit janë rritur në vitin 2022 duke qenë se ka ndryshuar tarifa e depozitimit në lëndfillin e Bushatit.<sup>15</sup> Kështu, në vitin 2022 janë shpenzuar rreth 91.7 milionë lekë vetëm për depozitimin në lëndfill nga 91.3 milionë lekë që kanë shkuar për grumbullimin, pastrimin dhe transportimin e mbetjeje.

Tab. 5 Buxheti i mbetjeje i Bashkisë Shkodër i ndarë (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)

mijë lekë

	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Grumbullim, transport, pastrim	97,333	93,864	91,379	137,787
Depozitimi ne lëndfill	34,260	27,449	91,794 <sup>16</sup>	49,872
Totali i buxhetit të mbetjeje	131,593	121,313	183,173	187,659

Burimi: Bashkia Shkodër

Përpunoi: Grupi i auditimit

### **Bashkia Vlorë**

Sa i përket Bashkisë Vlorë duhet theksuar që Bashkia Vlorë (duke qenë se nuk i depoziton mbetjet në një lëndfill i cili duhet të plotësojë kriteret e ligjit të menaxhimit të mbetjeje<sup>17</sup> dhe ligjit për lejet e mjedisit), nuk paguan tarifë për depozitimin e mbetjeje në lëndfill. Buxheti total i Bashkisë Vlorë ka ardhur në rritje nga viti në vit nga 2.79 miliardë lekë në vitin 2020 në 3 miliardë lekë në vitin 2022. Gjithashtu edhe shpenzimet për menaxhimin e mbetjeje kanë ardhur në rritje nga 268.8 milionë lekë në vitin 2020 në rreth 340.3 milionë lekë në vitin 2022.

Tab 6. Buxheti i Bashkisë Vlorë dhe i mbetjeje urbane

mijë lekë

<b>Bashkia Vlorë</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
Buxheti (fakt) total i Bashkisë	2,798,725	3,244,058	3,005,701	3,315,477
Buxheti (fakt) i menaxhimit të mbetjeje	268,845	182,653	340,300	132,312
Raporti i buxhetit të mbetjeje me buxhetin total (%)	9.6	5.6	11.3	4

Burimi: Bashkia Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>15</sup> Tarifat e depozitimit në lëndfille dhe ndryshimi i tyre në vite do të trajtohet më në detaje gjatë fazës së terrenit dhe Projekt Raportit të këtij auditimi.

<sup>16</sup> Shënim: Shpenzime te mbartura nga viti 2021 me rritjen e tarifës të depozitimit të mbetjeje në lëndfillin e Bushatit

<sup>17</sup> Shënim: Proceset dhe situata më e detajuar lidhur me menaxhimin e mbetjeje urbane në secilën bashki do të trajtohet në pyetjet audituese në Projekt Raportin e Auditimit.

Tab. 7 Buxheti i mbetjeve i Bashkisë Vlorë i ndarë (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)

	mijë lekë			
	2020	2021	2022	2023
Grumbullim, transport, pastrim	268,845	182,653	340,300	132,312
Depozitimi ne lendfill <sup>18</sup>				
<b>Totali i buxhetit të mbetjeve</b>	<b>268,845</b>	<b>182,653</b>	<b>340,300</b>	<b>132,312</b>

Burimi: Bashkia Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

### **Bashkia Korçë**

Referuar tabelës nr. 8, buxheti total i Bashkisë Korçë ka ardhur në rritje nga viti 2020 me rreth 1.35 miliardë lekë në rreth 1.6 miliardë lekë në vitin 2022. Në rritje paraqiten edhe shpenzimet mbi menaxhimin e mbetjeve urbane ku për vitin 2020 janë shpenzuar rreth 102.6 milionë lekë ndërsa për vitin 2022 rreth 114 milionë lekë.

Tab 8. Buxheti i Bashkisë Korçë dhe i mbetjeve urbane

	mijë lekë			
<b>Bashkia Durrës</b>	2020	2021	2022	2023
Buxheti (fakt) total i Bashkisë	1,351,199	1,484,215	1,607,320	1,799,705
Buxheti (fakt) i menaxhimit të mbetjeve	102,621	132,653	114,899	135,061
Raporti i buxhetit të mbetjeve me buxhetin total (%)	7.6	8.9	7.1	7.5

Burimi: Bashkia Korçë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në tabelën nr. 9 shpenzimet mbi grumbullimin, pastrimin dhe transportin paraqiten në nivele thuajse konstante nga viti në 2020 në 2022 dhe konkretisht rreth 75 milionë lekë në 2020 dhe rreth 74 milionë lekë në 2022. Ndërsa sa i përket shpenzimeve mbi depozitimin në lendfill vihet re një rritje ndër vite, (kujtojmë se Bashkia Korçë i depoziton mbetjet e saj në lendfillin e Maliqit), ku për vitin 2020 janë shpenzuar rreth 27.1 milionë lekë dhe për vitin 2022 40.2 milionë lekë.

Tab. 9 Buxheti i mbetjeve i Bashkisë Korçë i ndarë (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)

	mijë lekë			
	2020	2021	2022	2023
Grumbullim, transport, pastrim	75,514	82,657	74,670	102,515
Depozitimi ne lendfill	27,107	49,996	40,229	32,546
<b>Totali i buxhetit të mbetjeve</b>	<b>102,621</b>	<b>132,653</b>	<b>114,899</b>	<b>135,061</b>

Burimi: Bashkia Korçë

Përpunoi: Grupi i auditimit

## **2.5 Përkufizimet dhe terminologjia**

“**Grumbullim i diferencuar**” është grumbullimi, sipas të cilit një rrymë mbetjesh ndahet, në përputhje me llojin dhe natyrën, për të bërë të mundur një trajtim specifik.

“**Grumbullim**” është mbledhja, përfshirë ndarjen paraprake dhe magazinimin paraprak të mbetjeve për transportimin e tyre në impiantet e përpunimit të mbetjeve.

“**Krijues i mbetjeve**” është çdo person, veprimtaritë e të cilit krijojnë mbetje, (krijuesi fillestar i mbetjeve) ose çdo person, që kryen përpunimin paraprak, përzierjen ose operacione të tjera që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së asaj mbetjeje.

“**Impiant incinerimi**” është çdo pajisje dhe njësi teknike, e palëvizshme ose e lëvizshme, që përdoret për trajtimin termik të mbetjeve, që e rikuperon ose jo nxehtësinë që krijohet nga djegia. Këtu përfshihet incinerimi i mbetjeve me oksidim, si dhe procese të tjera të trajtimit termik, si piroliza, gazifikimi ose proceset e plazmës, pas të cilave substancat, që përftohen nga trajtimi, incinerohen. Ky përkufizim mbulon vendndodhjen dhe të gjithë impiantin e incinerimit, përfshirë

<sup>18</sup> Në rastin e Bashkisë Vlorë për periudhën nën auditim nuk ka pasur shpenzime për zërin “depozitim në lendfill” duke qenë se mbetjet urbane të kësaj bashkie nuk depozitohen në lendfill.

të gjitha linjat e incinerimit, vendin e pranimit të mbetjeve, të magazinimit, impiantet e para trajtimit në vend, sistemet e furnizimit me mbetje, lëndë djegëse dhe ajër, bojlerët, impiantet për trajtimin e gazrave të shkarkimit, impiantet për trajtimin ose magazinimin në vend të tepricave të mbetjeve dhe ujërave të përdorura, pajisjet e oxhaqeve dhe sistemet e kontrollit të operacioneve të incinerimit, të regjistrimit dhe të monitorimit të kushteve të incinerimit.

“**Lendfill**” është fusha e asgjësimit të mbetjeve të ngurta mbi ose nën tokë, përfshirë:

a) një vend ku mbetjet asgjësohen brenda territorit të impiantit që i ka krijuar, siç është rasti i lendfillit ku krijuesi i mbetjeve i asgjëson mbetjet e veta në vendin e prodhimit;

b) një vend të përhershëm që përdoret për ruajtjen e përkohshme, zakonisht për më shumë se një vit, të mbetjeve me përjashtim të:

i) impianteve ku mbetjet shkarkohen për t’u përgatitur për t’u transportuar më pas për rikuperim, trajtim apo asgjësim diku tjetër;

ii) vendeve ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet përpara se të rikuperohen ose të trajtohen;

iii) vendet ku mbetjet ruhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se një vit përpara asgjësimit të tyre.

“**Lëng kullues**” është çdo lëng që rrjedh prej mbetjeve të depozituara dhe që shkarkohet ose mbetet në lendfill;

“**Mbetje e ngurtë**” është një lëndë, një objekt ose pjesë e tij, të cilat nuk përdoren më ose që zotëruesi do t’i hedhë. Lëndët, objektet ose pjesët e tyre vlerësohen si mbetje, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

“**Mbetje bio**” janë mbetjet e biodegradueshme nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, katering-u dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve.

“**Menaxhim i integruar i mbetjeve**” është grumbullimi, transporti, rikuperimi dhe asgjësimi i mbetjeve dhe mbikëqyrja e këtyre operacioneve, kujdesi i mëtejshëm për vendet e asgjësimit, si dhe veprimet e ndërmarra në cilësinë e tregtarit apo agjentit.

“**Operator**” është personi që:

a) është përgjegjës për vendin e asgjësimit ose të rikuperimit të mbetjeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Personi përgjegjës në fazën e përgatitjes mund të jetë i ndryshëm nga personi përgjegjës në fazën e kujdesit të mëtejshëm pas mbylljes së lendfillit;

b) kontrollon impiantin e incinerimit të mbetjeve.

“**Parandalim**” janë masat që merren para se një substancë, material ose produkt të kthehet në mbetje, me qëllim që të pakësohet:

a) sasia e mbetjeve, përfshirë masat për ripërdorimin e produkteve ose zgjatjen e jetës së tyre;

b) ndikimi i padëshirueshëm i mbetjeve në mjedis ose në shëndetin e njeriut;

c) përmbajtja e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

“**Rikuperim**” është çdo operacion, rezultati kryesor i të cilit është që:

a) mbetjet të shërbejnë për një qëllim të dobishëm, duke zëvendësuar materiale të tjera, që do të përdoren në rast të kundërt për të përmbytur një funksion të caktuar;

b) mbetjet të përgatiten për të përmbytur një funksion të caktuar në një impiant apo më gjerë.

“**Riciklim**” është çdo operacion rikuperimi, me anë të të cilit materialet e mbetjeve ripërpunohen për t’u shndërruar në produkte, materiale apo substanca, për t’u përdorur, si për qëllimin fillestar, ashtu edhe për qëllime të tjera. Riciklimi përfshin ripërpunimin e materialeve organike, por nuk përfshin rikuperimin e energjisë dhe ripërpunimin që u bëhet mbetjeve për t’i shndërruar në materiale që përdoren si lëndë djegëse apo si lëndë mbushëse.

“**Ripërdorim**” është çdo operacion, me anë të të cilit produktet ose përbërësit që nuk janë mbetje përdoren përsëri për të njëjtin qëllim, për të cilin ishin krijuar.

“**Ruajtje e përkohshme**” është mbajtja në një vend, me qëllim ruajtjen e mbetjeve për një periudhë kohe jo më shumë se një vit, pa kryer operacione që çojnë në ndryshimin e natyrës ose të përbërjes së mbetjeve.

“Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve” është optimizimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit të integruar të mbetjeve, duke marrë në konsideratë grupet e interesit, elementet e menaxhimit të integruar të mbetjeve, si dhe aspektet e menaxhimit të qëndrueshëm, për të promovuar teknikat më të mira të disponueshme, ekonomisht të zbatueshme dhe të pranueshme nga ana sociale, pa degraduar mjedisin.

“Transportim” është tërësia e operacioneve që përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin, si dhe përgatitjen, shërbimin e mirëmbajtjen e automjeteve, që përdoren për të transportuar mbetjet.


“Trajtim” janë operacionet e rikuperimit ose të asgjësimit, përfshirë përgatitjen para rikuperimit ose asgjësimit.

“Vendndodhja e mbetjeve” është vendi ku ndodhet lëndfilli apo incineratori apo çdo vend tjetër ku, sipas këtij ligji, lejohet të kryhen asgjësimi, depozitimi i përhershëm, trajtimi ose rikuperimi i mbetjeve.

“Zotërues i mbetjeve” është krijuesi i mbetjeve ose çdo person që zotëron mbetje.

## 2.6 Skema e analizës së programit auditues

Skema 1: Modeli Input – Output





## 2.7 Feedback-u i subjektit


Stafet përgjegjëse të Bashkive Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Durrës i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë pyetësorëve të dërguar nga grupi i auditimit, ndërsa për plotësimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me vjeljen e të dhënave plotësuese mbi tregues dhe indikatorë të ndryshëm, kërkuar më shumë kohë në përgjigjet e tyre kjo edhe për shkak të natyrës dhe kompleksitetit të informacioneve të kërkuara nga grupi i auditimit.

## 3. DETAJET E AUDITIMIT

### 3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë risqet e katër fushave në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht termi SWOT është një akronim për (*Strengths, Weakness, Opportunities and Threats*) Fuqi, Dobësi, Mundësi dhe Kërcënime. Analiza SWOT është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar. Ajo mundëson gjendjen aktuale të subjekteve nën auditim, për të diagnostikuar me saktësi problemet. Gjatë përdorimit të kësaj analize është mbajtur në konsideratë që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Duke iu referuar kësaj analize, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial.


Fig.1 Analiza SWOT



### 3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë” ka pasur si objektiv kryesor vlerësimin dhe analizimin e masave të marra nga institucionet përgjegjëse mbi mënyrën e menaxhimit të mbetjeve urbane, ndikimin që ato kanë në buxhetin e shtetit, impaktin në shëndetin e komuniteteve që jetojnë në këtë zona dhe mjedisin rrethues. Në këtë mënyrë është synuar të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi mbi nismat dhe iniciativat të cilat institucionet përgjegjëse kanë marrë mbi menaxhimin e mbetjeve. Me anë të këtij objektivi është bërë e mundur vlerësimi mbi efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi për periudhën 2020-2023.

### 3.3 Pyetjet e auditimit



### 3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim ka pasur si fushëveprim analizimin dhe dhënien e një opinioni mbi respektimin dhe përmirësimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane veçanërisht sa i përket shpenzimeve financiare si dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis dhe shëndetin e popullatës. Në kuadër të këtij auditimi janë vizituar të katër bashkitë subjekt auditimi për të mbledhur informacion sa më të saktë mbi sasitë e gjenerimit të mbetjeve urbane, shpenzimeve dhe të ardhurave që mblidhen me qëllim mbulimin e kostove të menaxhimit, si edhe procesit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit final të tyre. Në zbatim të Programit të Auditimit në të katër bashkitë janë kryer vizita në terren për të parë nga afër të gjithë procesin e grumbullimit, trajtimit dhe transportit të mbetjeve për në destinacionin final të asgjësimit të tyre. Më konkretisht, krahas përlllogaritjeve dhe krahasimeve midis 4 bashkive sa i përket shpenzimeve totale të kryera mbi menaxhimin e mbetjeve urbane, janë vlerësuar dhe analizuar çështje që kanë të bëjnë me arritjen e objektivave të riciklimit dhe kompostimit si dhe uljes së volumit që shkon në lëndfill. Institucionet subjekt auditimi kanë qenë Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Periudha objekt auditimi siç është theksuar dhe më sipër është 2020-2023, megjithatë të dhëna historike jashtë kësaj periudhe janë pasqyruar për të dhënë një panoramë më të qartë të ecurisë së treguesve të ndryshëm.

## **4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE**

### **Pyetja kryesore: A ËSHTË SIGURUAR MENAXHIM I DUHUR I MBETJEVE URBANE NË BASHKITË DURRËS, SHKODËR, KORÇË DHE VLORË?**

#### **Mesazhi i auditimit**

Menaxhimi i mbetjeve urbane vijon të mbetet një sfidë e vazhdueshme për Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë. Këto bashki nuk kanë garantuar menaxhim të integruar të mbetjeve urbane duke mos zbatuar hierarkinë e mbetjeve në drejtim të parandalimit, ripërdorimit, reduktimit dhe riciklimit. Gjithashtu, këto bashki nuk kanë arritur të minimizojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve për të përfituar të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre. Në veçanti, në Bashkinë Durrës, menaxhimi i mbetjeve urbane nuk garanton qëndrueshmëri financiare sepse nuk mbulohen shpenzimet me të ardhurat e krijuara. Ndërsa, menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë përveç se nuk respekton standardet mjedisore, shkakton probleme serioze shëndetësore në komunitet si dhe efekte negative në ekonominë lokale dhe turizmin bregdetar. Është e rëndësishme që këto bashki të angazhohen për të ndryshuar këtë situatë dhe për të krijuar një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm për të gjithë.

#### **4.1 Si është situata e menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?**

##### **4.1.1 A i ka shërbyer skema e organizimit të menaxhimit të mbetjeve, optimizimit të kostove të tyre në bashkitë nën auditim?**


Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve që ka si qëllim renditjen e mundësive të menaxhimit të mbetjeve, duke u nisur nga çfarë është më e mirë për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe kalimin drejt ekonomisë qarkulluese, siç paraqitet në figurën 2. Përparësi i jepet parandalimit të mbetjeve, duke synuar mbajtjen sa më gjatë si produkte. Në rastet kur produkti shndërrohet në mbetje, përparësia i jepet ripërdorimit, më pas riciklimit, më tej rikuperimit dhe në fund depozitimit (ose asgjësimit final).<sup>19</sup> Ndarja në burim është përgjegjësi e NJVQV-së. Sistemet e riciklimit për ambalazhet dhe për mbetje të tjera specifike duhet të ngrihen nga prodhuesit e produkteve dhe/ose industrinë e riciklimit nën skemat e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit. Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore dhe të organeve përkatëse në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre. Në mënyrë të veçantë, “grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake” është përcaktuar si një funksion “i veti” i bashkive.

Industria e riciklimit është një nga aktorët më të rëndësishëm në menaxhimin e mbetjeve. Riciklimi në vetvete është ndoshta elementi më thelbësor dhe forma më e njohur për zvogëlimin e mbetjeve që zhvillohet nëpërmjet një zinxhiri procesesh, duke përfshirë ndarjen në burim, grumbullimin e diferencuar, përzgjedhjen dhe përpunimin, që çon në zvogëlimin e një sasive të konsiderueshme të mbetjeve që depozitohen në lëndfill.

---

<sup>19</sup> Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve, 2020–2035, Kap 1.3.1

Fig. 2 Hierarkia e mbetjeve



Burimi: Plani Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve

### **Bashkitë Vlorë dhe Korçë nuk kanë përlogaritur numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së popullsisë**

Një ndër treguesit kryesorë që duhet pasur në konsideratë në procesin e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane është popullsia. Në vendin tonë të dhënat për popullsinë sipas bashkive nuk janë të sakta dhe të përditësuara. Për këtë arsye, përlogaritja e numrit të popullsisë bëhet sipas një metode specifike, e cila përdoret nga Ministria e Financave për të përlogaritur transfertën e pakushtëzuar kundrejt njërive të vetëqeverisjes vendore. Duke qenë se popullsia është një tregues i cili lidhet shumë ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime, ai është një kriter thelbësor edhe për menaxhimin e mbetjeve urbane. Më konkretisht, përlogaritja e përafërt e popullsisë kryet nëpërmjet llogaritjes së koeficientit të përshtatjes së popullsisë si më poshtë:

<b>Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë</b>		<b>30%</b>
Banorë rezidentë efektivë [CENSUS + (Regjistri i gjendjes civile – Census)*30%]		<b>3.335.004</b>

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censurit të vitit 2011, të azhornuara me normën e rritjes së popullsisë në nivel qarku sipas vlerësimit të bërë nga INSTAT në vitin 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censurit dhe Gjendjes Civile për secilën njësi të qeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e qeverisjes vendore sipas Censurit të vitit 2011 (të azhornuar me normën rajonale të rritjes së popullsisë në vitin 2014) ka 30.000 banorë, ndërsa sipas gjendjes civile rezulton të ketë 45.000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë  $30.000 + (45.000 - 30.000) * 30\% = 34.500$  banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të qeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezulton rreth 3.3 milion banorë, nga 2.9 milion që raportohet nga Censusi dhe 4.3 milion që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm, dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censurit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.<sup>20</sup> Kjo theksohet edhe në Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, Datë 13.01.2020. Në tabelën nr. 10 është paraqitur numri i popullsisë aktive për të 4 bashkitë subjekt auditimi.

<sup>20</sup> VKM nr. 319, date 31.05.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”.

Tab. nr. 10

## Popullsia në Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë

Viti	Bashkia Shkodër	Bashkia Durrës	Bashkia Vlorë	Bashkia Korçë
2020	157,791	236,182	134,216	92,164
2021	157,893	237,362	134,447	92,101
2022	158,668	238,523	134,980	92,001
2023	158,893	225,004	134,980	91,930

Burimi: Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë

**Fact box**

Megjithëse bashkitë raportojnë sasitë e grumbulluara të mbetjeve, për shkak të mungesës së peshoreve urë në vendgrumbullimet bashkiake (si për shembull rasti i Vlorës dhe Durrësit përpara se t'i çonte në Lendfillin e Sharrës) të dhënat e raportuara mund të konsiderohen si llogaritje të përafërta. Edhe peshoret urë ekzistuese në vend depozitimet sanitare si për shembull ai në Bushat (ku depozitohen mbetjet e Shkodrës) përdoren në mënyrë jo të përshtatshme dhe të dhënat e grumbulluara në lidhje me sasinë e mbetjeve të dorëzuara nuk integrohen në një sistem informacioni digjital për mbetjet.<sup>21</sup>

Në tabelën nr. 11 paraqitet sasia totale e mbetjeve të gjeneruara për të gjitha bashkitë subjekt auditimi për periudhën 2020-2023. Nga ajo që vihet re nga të dhënat e raportuar nga bashkitë subjekt auditimi, Bashkia Durrës është bashkia që gjeneron sasinë më të madhe të mbetjeve krahasuar me Bashkitë Vlorë, Shkodër e Korçë. Megjithatë, nëse do t'i referohemi gjenerimit për kg/banor/vit Bashkia Vlorë gjeneron më shumë se Bashkia Durrës. Nga përgjigjet zyrtare të Bashkisë Vlorë është bërë e ditur se përgjatë periudhës korrik 2022 e deri në qershor 2023 mbetjet që grumbulloheshin peshoheshin (me anë të një peshoreje elektronike) para se të depozitoheshin në fushën e depozitimit në qytetin e Vlorës. Kjo tregon qartë domosdoshmërinë dhe nevojën e një peshoreje veçanërisht në raste kur shërbimi kryhet nga operatorët ekonomikë privatë. Nga ana tjetër, Bashkia Korçë gjeneron më pak mbetje si në total ashtu edhe në raport me popullsinë. Një rol të rëndësishëm në gjenerimin e më shumë mbetjeve nga ana e bashkive të Vlorës dhe Durrësit është edhe numri i lartë i turistëve të cilët akomodohen në strukturat pritëse të këtyre bashkive. Megjithatë, në mungesë të të dhënave të sakta për të gjithë treguesit e sipër përmendur është shumë e vështirë që të dilet në konkluzion të saktë.

Tab. nr 11 Sasia e mbetjeve të gjeneruara (në ton) për vitet 2020-2023

Viti	Bashkia Shkodër	Bashkia Durrës	Bashkia Vlorë	Bashkia Korçë
2020	37,428	72,170	60,110	16,676.46
2021	34,591	55,520	56,220	19,664.44
2022	34,748	63,010	51,222	17,195.04
2023	34,798	67,323	44,423	16,267.45

Burimi: Bashkitë subjekt auditimi


Tab. nr. 12 Popullsia dhe sasia e mbetjeve të gjeneruara

Bashkia	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Mbetje kg/banor Viti 2023
Shkodër	237	219	219	219
Durrës	305	234	264	299
Vlorë	448	418	379	329
Korçë	181	213	187	177

Burimi: Bashkitë subjekt auditimi

<sup>21</sup> Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, Datë 13.01.2020, fq 57.

Graf. nr. 2 Gjenerimi i mbetjeve urbane për kg/banorë në bashkitë e audituara për vitet 2020-2023



Burimi: Bashkitë subjekt auditimi

Përpunoi: Grupi i auditimit

*Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Shkodër*

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km<sup>2</sup>, i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë. Bazuar në reformën e re administrative dhe territoriale, të miratuar në Korrik 2015, Bashkia e madhe Shkodër përbëhet nga 11 Njësi Administrative (Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postrisë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë), ku kryeqendra e bashkisë është qyteti i Shkodrës.

Foto 1 Rruga Edit Durham, Shkodër



Foto 2. Rruga Besnik Cela, Shkodër



Burimi: Grupi i auditimit

Bashkia Shkodër e ofron shërbimin e pastrimit përmes kontraktimit të kompanive private. I gjithë territori i bashkisë është ndarë në tre zona shërbimi përkatësisht (i) NjA Shkodër, (ii) NjA Ana e Malit, Berdicë, Dajç, Velipojë dhe Guri i Zi dhe (iii) Nj.A. Postrisë, Rrethina, Shalë, Shosh.

(i) NJA Shkodër përbëhet nga qyteti i Shkodrës, i cili është i ndarë në 5 lagje dhe në dy lagje periferike, Shiroka dhe Zogaj që përfshihen në Lagjen Nr.1. Shërbimi në këtë Nj.A. ofrohet nga sipërmarrësi privat “A.I.C.” gjatë 7 ditëve të javës. Në disa pika të qendrës të qytetit përcaktuar nga grafiku i Drejtorisë të shërbimeve publike ku edhe fluksi është me i dendur me banorë dhe biznese. Në të gjithë qytetin sipas kontratës dhe specifikimeve teknike ka në terren të shpërndarë **682** konteinerë metalik 1.1m<sup>3</sup>. Për pastrimin e Nj.A. Shkodër zonën qendrore shërbejnë 80 punonjës, 8 mjete 10 ton dhe një 3-5 ton për mbledhjen derë më derë plus një rezervë 10-11 ton.

(ii) Njësitë administrative Ana e Malit, Berdicë, Dajç, Velipojë dhe Guri i Zi, janë njësi të zonës funksionale perëndimore. Shërbimi në këtë zonë realizohet nga operatori “R.” shpk. Në territor mbetjet evadohen nga një numër prej 359 konteinerë 1.1 m<sup>3</sup> dhe 125 i shtohet Nj.A. Velipojë gjatë sezonit turistik. Për shërbimin e pastrimit të kësaj zone funksionale përfshihen 40 punëtorë, 10 për gjatë gjithë vitit dhe 30 vetëm në sezonin turistik. Ka në përdorim 2 (dy) mjete nga 10 ton për gjatë gjithë vitit, 1 mjet 10-11 ton shtesë për sezon dhe një mjet 5-6 ton për mbledhjen derë më derë dhe një mjet 5-10 ton rezervë. Frekuencat janë dy herë në javë në njësitë administrative dhe dy herë në ditë përgjatë sezonit turistik në plazh Velipojë.

(iii) Njësitë Postrinë, Rrethina, Gur i Zi dhe Shalë janë njësi të zonës funksionale lindore. Shërbimi në këtë zonë realizohet nga bashkimi i operatorëve K.G.K shpk & A.K. shpk dhe C. sh.p.k. Në këtë zonë evadohen mbetje nga 220 konteinerë dhe 57 në nja shalë (fshatrat turistike). Për shërbimin e pastrimit të kësaj zone janë përfshirë , 13 punëtorë, dy mjete nga 10 ton 1 mjet 7 ton, dhe një mjet 10 ton rezervë. Frekuenca e pastrimit në këto njësi realizohet tre herë në javë ndërsa në zonën turistike të fshatrave të Nj.A Shalë (Theth, Okol, Ndërllysaj etj. ) realizohet 2 herë në javë gjatë muajve prill-nëntor.

Lidhur me depozitimin e mbetjeve urbane, Bashkia Shkodër i depoziton ato në lëndfillin e Bushatit e cila administrohet nga Shoqëria “Ndërkomunale Bushat” sh.a. Tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane e vendosur nga subjekti “Ndërkomunale Bushat” sh.a. deri në vitin 2020 ka qenë 863 lekë/ton pa tvsh, tarifë e cila ka ndryshuar më 01.01.2021 në 1500 lek/ton pa tvsh.

#### *Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Durrës*

Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Sipas ndarjes së re territorial Bashkia Durrës ka një sipërfaqe prej 383 km<sup>2</sup> dhe përbëhet Njësitë Administrative Durrës, Sukth, Ishëm, Katundi i Ri, Rrashbull dhe Manëz. Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës (ne cila është në varësi të Bashkisë Durrës) mbulon shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në Njësitë Administrative Durrës, Katundi i Ri dhe Manëz. Ndërmarrja Komunale Plazh (ndërmarrje në varësi të Bashkisë Durrës) mbulon Njësinë Administrative Rrashbull si dhe Lagjet nr. 13 dhe 14 të Njësisë Administrative Durrës. Për Njësitë Administrative Sukth dhe Ishëm shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane kryhet nga sipërmarrësi privat. Në të gjithë Bashkinë e Durrësit ndodhen 491 pika grumbullimi dhe 1546 konteinerë me kapacitet 1.1 m<sup>3</sup>. Mjetet teknologjike qe kane mbuluar grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane për vitet 2020- 2023 paraqiten në tabelën më poshtë.

Tab nr 13 Lista e mjeteve që operojnë në Bashkinë Durrës

Emërtimi i mjetit	Kapaciteti	sasia
Kamion teknologjik për kontejnerët	20 m <sup>3</sup>	5
Kamion teknologjik për kontejnerët	16 m <sup>3</sup>	1
Kamion vetëshkarkues	10 m <sup>3</sup>	4
Kamion vetëshkarkues	16 m <sup>3</sup>	1
Kamion vetëshkarkues	8 m <sup>3</sup>	2
Fadromë me kovë përpara		2
Kamioncinë	2.5 m <sup>3</sup>	3
Motokarro		1

Kamionë	7 ton	5
Kamioncinë	2 ton	5
Agregatë	9 ton	8

Burimi: Bashkia Durrës

Që prej tetorit të vitit 2021 të gjitha mbetjet urbane të Bashkisë Durrës depozitohen në Lendfillin e Sharrës me një kosto prej 29 euro/ton ose 3500 lek/ton. Bashkia Durrës me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 10.06.2021 ka miratuar Skenarin e Menaxhimit të Mbetjeve, bazuar në Vendimin nr. 6 datë 20.05.2021 të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve dhe Vendimin nr. 3 datë 02.06.2021 të Këshillit të Qarkut. Ky Skenar është propozuar nga ish AKUMI (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve). Sipas këtij Skenari do të duhej të zbatohet sistemi i mbledhjes së dy llojeve të koshave (1 kosh për mbledhjen e materialeve të riciklueshme dhe 1 kosh për grumbullimin e mbetjeve të mbetura bashkiake). Të gjitha mbetjet e grumbulluara në këto dy lloje koshave duhet të transferohen në Qendrën e Menaxhimit të Mbetjeve në Tiranë ose ndryshe e njohur si Lendfilli i Sharrës. Në vijim, Bashkia Durrës me anë të një Marrëveshjeje Kuadër ka lidhur kontratë me nr. 9853/7 prot. datë 08.10.2021 me Kompaninë “I.E. BV SPV” për depozitimin e mbetjeve urbane në Lendfillin e Sharrës.

Foto 3 & 4 Rruga Aleksandër Goga, Durrës



Burimi: Grupi i auditimit

### *Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Vlorë*

Bashkia e Vlorës e cila shtrihet në një sipërfaqe totale prej 617 km<sup>2</sup> e rikonceptuar pas zbatimit të reformës administrative territoriale në vitin 2015 bashkoi këto ish-njësi të qeverisjes vendore: Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë, Shushicë dhe Vlorë, të cilat u shndërruan në njësi administrative bashkiake. Në Bashkinë e Vlorës veprojnë më shumë se 6,600 biznese, të cilat sjellin të ardhurat kryesore për buxhetin e bashkisë. Qytetet e Vlorës dhe Orikumit si dhe fshati Rradhimë janë përfshirë përgjatë dekadës së fundit nga një bum ndërtimi, i cili ka krijuar mbingarkesë të infrastrukturës dhe probleme në mjedis dhe në menaxhimin e mbetjeve të ngurta. Ushttrimin e funksionit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, në planifikim, financim, zbatim dhe monitorim, bashkia e përmbush përmes strukturave të saj, ku përfshihet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike (DIIP) që është drejtoria përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve dhe dy ndërmarrjet e bashkisë: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe MIM Vlorë. Vendgrumbullimi i mbetjeve në qytetin e Vlorës është më i madhi në territorin e bashkisë. Ai gjendet në rrethinat veriperëndimore të qytetit, në një zonë të përzier me zhvillime kryesisht industriale, por edhe me banesa të reja pranë. Distanca nga ndërtesat e banimit më të afërta është më pak se 50 m. Kështu, era e rëndë dhe tymi janë probleme serioze për banorët. Ngjitur me vendgrumbullimin, kalon një



rrëke/përrua nëpërmjet të cilit lëngjet derdhen në det, rreth 1,500 m larg. Vendgrumbullimi i Vlorës ndodhet në një vend të papërshtatshëm (duke qenë se është pranë vendbanimeve). Në shumicën e rasteve nuk ka struktura apo masa operative për reduktimin e emetimeve, që do të thotë nuk ka menaxhim të ujërave sipërfaqësore, nuk ka sistem bazë izolimi, sistem grumbullimi të lëngut e gazrave që krijohen nga mbetjet. Lëngu i prodhuar nga mbetjet shkakton ndotje të tokës si edhe të ujërave nëntokësore dhe ujërave sipërfaqësore; gazi që çliron vendgrumbullimi përhapet direkt në atmosferë. Për shkak se mbetjet nuk mbulohen me dhe, përbërësit e lehtë merrem nga era dhe ndotin zonat fqinje. Dëme të tjera vijnë nga zjarret në fushat e mbetjeve.<sup>22</sup>

Në territorin e Bashkisë Vlorë janë afërsisht 350 pika grumbullimi dhe rreth 900 kontenierë me kapacitet 1,1m<sup>3</sup>. Nga 03.07. 2020 – 03.07.2023 shërbimi i pastrimit ka qenë i kontraktuar dhe është realizuar nga kompania e pastrimit “D.” sh.pk, e cila e ka kryer këtë shërbim me mjetet e veta duke përfshirë 8 makina teknologjike 8-12 ton, 4 kamionçina 1,5 - 2,5 ton, skrep, 4 kamiona e fadroma. Sot këtë shërbim e kryhen Ndërmarrja e Shërbimeve Publike me mjetet e veta siç tregohen në tabelën nr.14. Përgjatë periudhës objekt auditimi, mbetjet që çohen në fushën e Vendgrumbullimit të Vlorës janë peshuar vetëm në korrik 2022 – qershor 2023. Kujtojmë se Bashkia Vlorë (ndryshe nga 3 bashkitë e tjera subjekt auditimit) nuk ka paguar asnjëherë tarifë për depozitimin e mbetjeve duke qenë se mbetjet e saj nuk i depoziton në Lendfill por në një fushë depozitimi të hapur në qytetin e Vlorës e cila nuk respekton standardet mjedisore.

Tab. nr.14 Lista e mjeteve që operojnë në Bashkinë Vlorë

<b>Emërtimi i mjetit</b>	<b>Kapaciteti</b>	<b>sasia</b>
Makina teknologjike	20 m <sup>3</sup>	6
Makina teknologjike	10 m <sup>3</sup>	6
Makina teknologjike	6 m <sup>3</sup>	4
Kamioncinë dopio kabinë		3
Skrep		1
Autofshesa për pastrimin e rrugëve		2
Kamion autovinç		1

Burimi: Bashkia Vlorë

#### *Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Korçë*

Bashkia Korçë përbëhet Njësitë Administrative Korçë, Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Drenovë, Mollas e Lekaj. Njësia Administrative Korçë e cila njihet ndryshe edhe si zona urbane e Bashkisë Korçë ndahet në 3 zona të cilat janë zona e vjetër e qytetit (zona 1/A dhe 1/B), zona perëndimore (zona 2) dhe zona jugore (zona 3). Njësitë e tjera Administrative të cilat njihen ndryshe edhe si zona rurale janë qendra të vogla banimi rurale të shpërndara në një territor pjesërisht malor. Në Bashkinë Korçë ndodhen gjithsej 480 pika grumbullimi të mbetjeve urbane nga të cilat 270 pika ndodhen në qytet dhe 210 pika në fshat. Në total, janë vendosur 620 kontejnerë nga të cilët 310 copë kanë përmasa 1.7 m<sup>3</sup> dhe 320 me përmasa 1.1 m<sup>3</sup>.

Tab. Nr. 15 Lista e mjeteve që operojnë në Bashkinë Korçë

<b>Emërtimi i mjetit</b>	<b>Kapaciteti</b>	<b>sasia</b>
Makina teknologjike	10 ton	6
Makina teknologjike	6 ton	3
<i>Makina ompetator</i>	4 ton	2
Makina të vogla për riciklim	1 ton	4
Fadroma	1 m <sup>3</sup>	1
Kamion vetëshkarkues	3 ton	1

<sup>22</sup> Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, Bashkia Vlorë, 2023-2028, fq. 22, 53, 54.

### *Burimi: Bashkia Korçë*

Që prej vitit 2018, në Qarkun e Korçës ka filluar depozitimi i Mbetjeve Urbane në Vend Depozitimit Sanitar të Mbetjeve ose siç njihet ndryshe Lendfilli i Maliqit. Që prej funksionimit të këtij Lendfilli, Bashkia Korçë dokumenton çdo sasi mbetjesh me anë të një fature e cila gjenerohet pasi mbetjet peshohen në Peshoren Elektronike të Lendfillit. Bashkia Korçë çdo muaj bën një situacion me peshat e përmbledhura në formularin mujor. Tarifa e depozitimit të mbetjeve në Lendfillin e Maliqit e cila paguhet nga Bashkia Korçë për vitin 2020 ka qenë 1781 lek pa tvsh, 1561 lek pa tvsh për vitin 2021, 1800 lek pa tvsh për vitin 2022 dhe 1815 lek pa tvsh për vitin 2023.<sup>23</sup>

Foto 5. Rruga Insan Korça, Korçë



Foto 6. Rruga 1 Maji, Korçë




Burimi: Grupi i auditimit

### *Trajtimi i mbetjeve urbane në BE dhe në bashkitë subjekt auditimi*

Sipas një auditimi të zhvilluar në vitin 2012 nga Gjykata Evropiane e Llogarive (ECA – European Courts of Auditors) vërehet se vende të ndryshme kanë përqindje të ndryshme sa i përket sasisë së mbetjeve që riciklojnë, kompostojnë, apo çojnë në incinerim ose lendfill. Kështu, Gjermania (e cila përbën edhe shembullin më pozitiv të trajtimit të mbetjeve midis vendeve të BE-së) në vitin 2012 trajtonte të gjitha mbetjet e saj me anë të metodës së incinerimit (38 %), riciklimit (45 %) dhe kompostimit (17 %), duke mos dërguar asnjë ton mbetje në lendfill. Nga ana tjetër Bullgaria (e cila përbën edhe shembullin më negativ të trajtimit të mbetjeve midis vendeve të BE-së) dërgonte 100 % të mbetjeve në lendfill. Kjo do të thotë se Gjermania mund të krijojë të ardhura dhe përfitime ekonomike nga incinerimi, riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve ndryshe nga Bullgaria e cila nuk krijon asnjë përfitim monetar nga trajtimi i mbetjeve duke qenë se të gjitha i mbetjet i gropa në lendfill.

<sup>23</sup> Sipas Vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë Administrimit i Mbetjeve i Qarkut Korçë, SH.A.

Graf. nr. 3 Trajtimi i mbetjeve urbane në BE



Burimi: European Courts of Auditors, Special Report No 20, 2012, fq 11


Mbetjet duhet të konsiderohen si një aset, nëpërmjet mënyrës së menaxhimit të së cilave, mund të maksimizohen përfitime ekonomike. Riciklimi i mbetjeve është një proces i rëndësishëm i cili mund të krijojë përfitime në të ardhura, duke qenë se këto mbetje mund të rikthehen përsëri në industri. Njësoj si riciklimi edhe kompostimi ose tretja e mbetjeve organike, të cilat kthehen në pleh ose lëndë ushqyese për tokën dhe sektorin e bujqësisë, mund të krijojë të ardhura shtesë për strukturën që menaxhon mbetjet urbane.<sup>24</sup> Në Portugali, vetëm nga procesi i kompostimit të mbetjeve organike, përfitohej rreth 71.8 euro për ton nga shitja e plehut organik.<sup>25</sup>

Në ngjashmëri me auditimin e ECA-s, është analizuar edhe situata e 4 bashkive subjekt auditimi sa i përket metodës së trajtimit të mbetjeve urbane. Sikurse mund të vërehet edhe nga grafiku më poshtë, në asnjë prej 4 bashkive nuk kryhet trajtimi i mbetjeve urbane nëpërmjet metodave të incinerimit, riciklimit dhe kompostimit. Bashkitë Shkodër, Korçë dhe Durrës (që prej tetorit të vitit 2023) i depozitojnë mbetjet në lëndfille të miratuara, ndërkohë që Bashkia e Vlorës i depoziton mbetjet urbane në një venddepozitim të pa miratuar dhe nuk përmbush kriteret dhe standardet mjedisore.

<sup>24</sup> Solid waste management in the world cities, UN HABITAT 2010, fq 22.

<sup>25</sup> European Courts of Auditors, Special Report No 20, 2012, fq 19.

Graf. nr.4 Trajtimi i mbetjeve urbane për vitet 2020-2023



Burimi: Bashkitë subjekt auditimi

Përpunoi: Grupi i auditimit

#### Kosto e menaxhimit të mbetjeve urbane

Për të vlerësuar eficiencën e përdorimit të fondeve publike u analizuan dhe krahasuan subjektet nën auditim lidhur me treguesit kryesorë të kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Si fillim është bërë një krahasim midis 4 bashkive lidhur me kostot totale që ato kanë mbi menaxhimin e mbetjeve urbane. Sigurisht që kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane ndikohen së pari nga volumi i mbetjeve që prodhohen dhe më tej nga metodologjia e trajtimit të tyre, ku një pjesë e mirë e shpenzimeve shkon për tarifën e depozitimit për lëndfillin ku mbetjet do të asgjësohen.

#### Bashkia Durrës nuk ka garantuar qëndrueshmëri financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane

Për të pasur një panoramë më të qartë për shpenzimet e bashkive mbi mbetjet urbane, është krahasuar raporti në përqindje i kostos totale të menaxhimit të mbetjeve urbane kundrejt buxhetit total të secilës bashki. Nga krahasimi vihet re se Bashkia Durrës që prej dërgimit të mbetjeve në lëndfillin e Sharrës thuhet se ka dyfishuar raportin e kostos totale të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të saj. Kështu, në vitin 2020 Bashkia Durrës shpenzonte rreth 15.2 % të buxhetit të saj vetëm për menaxhimin e mbetjeve, ndërsa në vitin 2022 ka shpenzuar 29.2 % ose afërsisht 1/3 e buxhetit të saj vetëm për mbetjet.

Në një studim<sup>26</sup> të Kombeve të Bashkuara, theksohet se qëndrueshmëria financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane është një çështje e rëndësishme për shumë qytete në të gjithë botën. Për qytetet në vendet në zhvillim (siç janë edhe bashkitë subjekt i këtij auditimit), menaxhimi i mbetjeve urbane përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të buxhetit total të bashkive, me shifra që duhet të jenë nga 3 deri në 15 për qind.

Tab. nr. 16 Përqindja e kostos totale të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit

Bashkia	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Shkodër	4.74 %	4.34 %	6.2 %	7.3 %
Durrës	15.2 %	17.3%	29.3 %	24.3 %
Vlorë	9.6 %	5.6 %	11.3 %	4 %
Korçë	7.6 %	8.9 %	7.1 %	7.5 %

Burimi: Bashkitë subjekt auditimi

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>26</sup> Solid waste management in the world cities, UN HABITAT 2010, fq 23

Treguesit kryesorë të kostove të menaxhimit të integruar të mbetjeve janë përcaktuar në VKM-në për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve<sup>27</sup>, e cila shërben si udhëzues për të gjitha bashkitë për të përllogaritur jo vetëm kostot, por edhe tarifat për mbulimin e këtij shërbimi.

Në tabelën më poshtë është paraqitur kosto totale e të gjitha bashkive subjekt auditimi për periudhën 2020-2023. Vihet re se Bashkia Durrës (e cila shpenzon më shumë se bashkitë e tjera subjekt auditimi) me depozitim të mbetjeve në Lendfillin e Sharrës që prej tetorit të 2021 i është rritur ndjeshëm kosto totale për menaxhimin e mbetjeve. Kështu nga 370,153,000 lekë që ka shpenzuar në vitin 2020, në vitin 2022 ka shpenzuar 964,074,000 lekë. Sigurisht, depozitimi i mbetjeve urbane në një Lendfill siç është ai i Sharrës do të sjellë kosto më të lartë, por, nëse e krahasojmë këtë shërbim me të njëjtin shërbim siç është ai që kryhet nga Bashkia Korçë dhe Shkodër, kosto e menaxhimit të mbetjeve urbane për banor/vit në rastin e Bashkisë së Durrësit është disa herë më e lartë se këto dy bashki. Konkretisht, për vitin 2022, Bashkia e Durrësit shpenzon 4,041 lekë për banor në vit, ndryshe nga Bashkia e Korçës që shpenzon 1248 lekë për banorë në vit dhe ajo e Shkodrës me 1,154 lekë për banorë në vit.


Tab. nr. 17 Kosto e menaxhimit të mbetjeve për banor

Bashkia	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto Banor/vit	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto Banor/vit	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto Banor/vit	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto Banor/vit
Shkodër	131,593	<b>834</b>	121,313	<b>768</b>	183,173	<b>1154</b>	187,659	<b>1181</b>
Durrës	370,153	<b>1567</b>	437,426	<b>1842</b>	964,074	<b>4041</b>	961,564	<b>4273</b>
Vlorë	268,845	<b>2003</b>	182,653	<b>1358</b>	340,300	<b>2521</b>	132,312	<b>980</b>
Korçë	102,621	<b>1113</b>	132,653	<b>1440</b>	114,899	<b>1248</b>	135,061	<b>1469</b>

Burimi: Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Graf. nr.5 Kosto në lekë për banor për vitet 2020-2023



Burimi: Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë.

Përpunoi: Grupi i auditimit

**Bashkia Vlorë nuk siguron menaxhim eficient të fondeve të dedikuara për mbetje urbane**  
 Bashkia Vlorë, ndryshe nga bashkitë e tjera nuk paguan tarifë depozitimi duke qenë se nuk i dërgon mbetjet në lendfill, por në një venddepozitim të pa miratuar në të cilin nuk respektohen kriteret dhe standardet ligjore e mjedisore. Ndaj, edhe pse mund të duket se Bashkia Vlorë shpenzon njësoj

<sup>27</sup> VKM nr. 319, datë 31.05.2018 “Për Miratimin e Masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve”

ose më pak se bashkitë e tjera, duhet thënë që ajo nuk arrin të përmbushi detyrimet ligjore mbi menaxhimin e mbetjeve urbane.

Në një auditim të kryer nga SAI i Lituaniës, rezultoi se për shkak të ndryshimeve në organizimin e proceseve dhe kostove të menaxhimit të mbetjeve urbane, kostot mesatare mujore për banorë për menaxhimin e mbetjeve urbane për vitin 2021 varionin nga 0.8 euro/muaj/banorë (Bashkia *Rokiškis*) deri në 4.0 euro (Bashkia *Moletai*).<sup>28</sup> Edhe në katër bashkitë Shkodër, Vlorë, Durrës e Korçë kosto mesatare për banor varion nga afërsisht 0.7 euro/muaj/banorë (Bashkia Shkodër viti 2020) deri në afërsisht 3.4 euro/muaj/banor (Bashkia Durrës, viti 2022). Megjithatë, duhet pasur në konsideratë që mesatarja e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në Lituani është 33%, ndërkohë që në katër bashkitë subjekt i këtij auditimi është zero. Grumbullimi i diferencuar kontribuon në rritjen e normës së riciklimit duke sjellë në këtë mënyrë reduktimin e sasisë që shkon në lëndfill dhe automatikisht reduktimin e shpenzimeve si rezultat i uljes së pagesës së tarifës së depozitimit. Si përfundim, pavarësisht se bashkitë Shkodër, Vlorë, Durrës e Korçë shpenzojnë afërsisht njësoj me bashkitë e Lituaniës ka një ndryshim thelbësor në performancën e tyre sa i përket menaxhimit të mbetjeve urbane dhe që lidhet me grumbullimin e diferencuar të tyre.

### **Bashkia Durrës për çdo ton të menaxhuar të mbetjeve urbane shpenzon rreth 3 herë më shumë se bashkitë e tjera**

Në vijimësi është trajtuar kosto e menaxhimit të mbetjeve urbane për ton. Bashkia Durrës për çdo ton të menaxhuar të mbetjeve urbane shpenzon 15,300 lekë në vit (viti 2022), ndërkohë që për të njëjtin vit, Bashkia e Shkodrës ka shpenzuar 5,271 lekë për ton dhe ajo e Korçës 6,682 lekë për ton. Krahasimi midis këtyre 3 bashkive bëhet për shkak se ato kanë ngjashmëri sa i përket trajtimit përfundimtar të tyre duke qenë se të treja i depozitojnë mbetjet urbane në Lëndfill.

Tab. nr. 18 Kosto e menaxhimit të mbetjeve urbane për ton/vit.

Bashkia	Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto ton/vit	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto ton/vit	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto ton/vit	Kosto totale (në mijë lekë)	Kosto ton/vit
Shkodër	131,593	3,516	121,313	3,507	183,173	5,271	187,659	5,392
Durrës	370,153	5,129	437,426	7,878	964,074	15,300	961,564	14,282
Vlorë	268,845	4,472	182,653	3,249	340,300	6,656	132,312	2,978
Korçë	102,621	6,153	132,653	6,745	114,899	6,682	135,061	8,302


Burimi: Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Një tjetër dukuri që vihet re në Bashkinë Durrës është se kosto e menaxhimit të mbetjeve urbane është trefishuar nga viti 2020 në vitin 2022 me ndryshimin e venddepozitimeve të mbetjeve në Lëndfillin e Sharrës.

<sup>28</sup> <https://www.valstybeskontrole.lt/EN/Product/24156/municipal-waste-management>

Graf. nr. 6 Kosto e menaxhimit të mbetjeve urbane të bashkive të audituara në lekë për ton/vit



Burimi: Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në tabelën nr. 19 janë paraqitur shpenzimet e bashkive nën auditim lidhur me depozitimin e mbetjeve urbane në lëndfillët përkatëse. Duke qenë se tarifa e depozitimit të mbetjeve për në lëndfill ndryshon nga njëri lëndfill në tjetrin edhe shpenzimet janë të ndryshme. Bashkia Durrës e cila shpenzon më shumë se bashkitë e tjera në vitin 2022 ka shpenzuar rreth 279 milionë lekë për depozitimin e mbetjeve në lëndfillin e Sharrës. Kjo shumë përbën rreth 29 % të shpenzimeve totale të menaxhimit të mbetjeve dhe 8.5 % të buxhetit total të kësaj bashkie, përqindje e cila është disa herë më e lartë se bashkitë e tjera.

Tab. nr. 19 Shpenzimet për depozitimin e mbetjeve në lëndfill


Vitet	Shpenzimet e Depozitimit për në lëndfill			
	Bashkia Durrës	Bashkia Shkodër	Bashkia Korçë	Bashkia Vlorë
2020	0	34,260,000	27,107,000	0
2021	15,486,000	27,449,000	49,996,000	0
2022	279,114,000	91,794,000	40,229,000	0
2023	295,584,000	49,872,000	32,546,000	0

Burimi: Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten lekët e shpenzuara për transportin e mbetjeve urbane nga konteinerët e grumbullimit në venddepozitimin final. Kujtojmë se Bashkia Durrës deri në tetor 2021 i ka depozituar mbetjet urbane në venddepozitimin e Porto Romanos i cili tashmë është mbyllur dhe është kthyer në park ekologjik, ndërsa që nga tetori i 2021 mbetjet depozitohen në Lëndfillin e Sharrës. Kështu, në vitin 2020 Bashkia Durrës ka shpenzuar 17,180,223 lekë për transportin e mbetjeve urbane, ndërsa në vitin 2022 ka shpenzuar 151,213,244 lekë. Si rezultat i depozitimit të mbetjeve urbane në Lëndfillin e Sharrës kosto e transportit të mbetjeve urbane është 9-fishuar nga viti 2020 në vitin 2022. Sa i përket kostot së transportit për 1 ton mbetje, në vitin 2020 Bashkia e Durrësit shpenzonte 238 lekë për çdo ton mbetje të transportuar, ndërkohë në vitin 2022 ka shpenzuar 2401 lekë duke bërë që kjo kosto të dhjetëfishohet përgjatë kësaj periudhe.

Graf. nr. 7 Kostot e transportit të mbetjeve urbane të Bashkisë Durrës për vitet 2020-2023



Burimi: Bashkia Durrës.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035 janë parashikuar edhe parimet bazë të menaxhimit të mbetjeve, të përcaktuara në Direktivën kuadër të menaxhimit të mbetjeve 2008/98/EC, që është transpozuar në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Një ndër këto parime është edhe “Parimi i afërsisë” i cili nënkupton që mbetjet duhet të depozitohen ose të rikuperohen në impiantet më të afërta dhe sa më afër vendit të gjenerimit të mbetjeve. Bashkia Durrës, i depoziton mbetjet urbane në Lendfillin e Sharrës i cili gjendet rreth 40 km larg qendrës së saj ndryshe nga Bashkitë Korçë e Shkodër të cilat i depozitojnë mbetjet e tyre në lendfilllet përkatëse në distanca 10-15 km. Kjo sjell që kostot e transportit (për ton mbetje të transportuar) të Bashkisë Durrës të jenë më të larta se në Bashkitë Korçë e Shkodër siç tregohet edhe në tabelën e mëposhtme.

Tab. nr. 20 Kostot e transportit të Bashkive Durrës, Shkodër dhe Korçë

Viti	Bashkia Shkodër		Bashkia Durrës		Bashkia Korçë	
	Kosto Transport Total	Kosto Transp/Ton	Kosto Transport Total	Kosto Transp/Ton	Kosto Transport Total	Kosto Transp/Ton
2020	36,018,424	962	17,180,223	238	13,656,314	819
2021	42,238,897	1221	64,598,700	1163	14,667,823	746
2022	33,139,145	953	151,312,244	2401	12,816,174	745

Burimi: Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë

Përpunoi: Grupi i auditimit

### Gjetje nga auditimi 1:

Bashkitë Vlorë dhe Korçë, në Planet Vendore të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM), nuk kanë përllogaritur numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë. Ky koeficient përdoret nga Ministria e Financave për të përllogaritur transfertën e pakushtëzuar kundrejt NJVQV-ve. Konkretisht, Bashkia Korçë në PVMIM ka përllogaritur popullsinë totale 103,500 banorë, ndërkohë sipas formulës së Ministrisë së Financave rezulton që popullsia për vitin 2023 të jetë 91,930 banorë. Po kështu edhe në PVMIM të Bashkisë Vlorë



popullsia është përlogaritur në 140,514 ndërkohë sipas formulës së Ministrisë së Financave rezulton që popullsia për vitin 2023 të jetë 134,980 banorë.

### **Gjetje nga auditimi 2:**

Bashkia Durrës nuk ka garantuar qëndrueshmëri financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane duke qenë se përqindja e kostove totale të menaxhimit të mbetjeve kundrejt buxhetit total të saj në vitin 2022 ka qenë 29.3 %. Qëndrueshmëria financiare në menaxhimin e mbetjeve urbane sipas Kombeve të Bashkuara garantohet kur ky tregues është në intervalin 3-15 %. Nga ana tjetër, edhe nëse e krahasojmë këtë tregues (për vitin 2022) të Bashkisë Durrës me bashkitë e tjera subjekt auditimi ai rezulton të jetë 3-4 herë më i lartë.

### **Gjetje nga auditimi 3:**

Në Bashkinë Vlorë, përqindja e kostove totale të menaxhimit të mbetjeve urbane kundrejt buxhetit total të saj ka lëvizur nga 4 deri në 11.3 %. Pavarësisht se ky tregues është brenda qëndrueshmërisë financiare të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara, Bashkia Vlorë nuk ka garantuar të njëjtin cilësi shërbimi në menaxhimin e mbetjeve urbane si në rastin e bashkive të tjera. Kjo mungesë cilësie vjen si rrjedhojë e mos depozitimit të mbetjeve urbane në një lëndfill të miratuar që respekton standardet ligjore e mjedisore. Në këtë situatë, Bashkia Vlorë nuk ka arritur një menaxhim eficient të fondeve të dedikuara për menaxhimin e mbetjeve urbane.

### **Gjetje nga auditimi 4:**

Në Bashkinë Durrës, për 1 ton të menaxhuar të mbetjeve urbane (viti 2022) është shpenzuar 15,300 lekë në vit, afërsisht 3 herë më shumë se në bashkitë e tjera. Kjo situatë është krijuar që kur mbetjet kanë filluar të depozitohen në lëndfillin e Sharrës. Për rrjedhojë Bashkisë Durrës (që prej tetorit të 2021) i është shtuar tarifa e depozitimit të mbetjeve (e cila në lëndfillin e Sharrës është 29 euro/ton). Aktualisht tarifa e depozitimit të mbetjeve urbane në lëndfill për Bashkinë Durrës është afërsisht 2 herë më e lartë se në Bashkitë Shkodër e Korçë. Gjithashtu, edhe distanca e transportimit të mbetjeve urbane për në lëndfill në rastin e Bashkisë Durrës është rreth 40 km, ose 2-3 herë më e lartë se në Bashkitë Shkodër e Korçë.

### **Konkluzione**

1. Të gjitha bashkitë subjekt auditimi nuk kanë arritur të optimizojnë kostot e menaxhimit të mbetjeve për të përfutur të ardhura nëpërmjet metodologjisë së trajtimit të tyre. Metodatat e trajtimit të mbetjeve që krijojnë të ardhura janë riciklimi, kompostimi dhe incinerimi. Shkaku për këtë situatë qëndron në faktin se këto procese nuk aplikohen gjatë trajtimit të mbetjeve urbane nga bashkitë e audituara.

#### **1.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të përlogarisin numrin e popullsisë sipas koeficientit të përshtatjes së të dhënave të popullsisë të miratuar nga Ministria e Financave për hartimin e dokumenteve zyrtare të menaxhimit të mbetjeve urbane.

**Në vazhdimësi**

#### **2.1 Rekomandimi:**

Bashkia Durrës të ngrëjë grup pune për të analizuar kostot e larta të menaxhimit të mbetjeve urbane që rëndojnë financat e saj, duke u orientuar drejt reduktimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në lëndfill, investimit në infrastrukturë për riciklim, si dhe të shqyrtojë alternativa të tjera të depozitimit të mbetjeve me distancë më të afërt.

**Brenda vitit 2024**

#### 4.1.2 A mbulojnë Bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e përfituara prej tyre?

Menaxhimi i mbetjeve urbane është një nga kompetencat e qeverisjes vendore, së bashku me funksionet që kanë të bëjnë me financimin: buxhetimi si dhe rikuperimi i kostos duke përfshirë vendosjen e tarifës së pastrimit<sup>29</sup>. Ligji “Për Financat Vendore”<sup>30</sup> ka përkufizuar konceptin e mbulimit të kostove përmes tarifave. Mbështetur në këtë ligj, niveli i tarifave orientohet drejt mbulimit të kostos së shërbimeve publike. NJVQV-të përcaktojnë tarifat e mbetjeve që duhen paguar nga gjeneruesit e tyre. Tarifa e pastrimit mbulon kostot e menaxhimit të mbetjeve nga grumbullimi deri në pikën fundore të asgjësimit<sup>31</sup>.

#### ***Bashkia Shkodër ka mbuluar kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit***

Për vitet 2020-2023 me VKB nr. 84 datë 26.12.2017 “Për miratimin e paketës fiskale” janë miratuar taksat dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Shkodër. Për të katër këto vite tarifat e menaxhimit të mbetjeve urbane kanë qenë të njëjta dhe nuk janë ndryshuar si për qytetin e Shkodrës ashtu edhe për 11 njësitë administrative të tij. Tarifa për familjet e qytetit, ka qenë 3,450 lekë në vit, për familjet në njësitë administrative 1,950 lekë në vit dhe për subjektet e ndryshme tregtare dhe institucione nga 5,500 lekë deri në 200,000 lekë në vit. Bazuar në këto tarifa dhe në numrin e familjeve dhe të subjekteve tregtare, janë planifikuar të ardhurat për mbulimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve për të gjithë territorin e bashkisë.

Tabela nr.21. Planifikimi dhe realizimi i te ardhurave nga tarifat e pastrimit të Bashkisë Shkodër

Tarifat	Viti 2020 000/leke			Viti 2021 000/leke			Viti 2022 000/leke			Viti 2023 000/leke		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
<b>Familjet</b>	68,790	72,661	106	73,699	62,011	84	75,500	72,621	96	75,500	77,173	102
<b>Bizneset</b>	82,162	76,456	93	96,012	95,577	96	95,863	110,715	115	95,863	107,252	112
<b>Totali</b>	150,952	149,117	99	169,711	157,588	93	171,363	183,336	107	171,964	184,425	107

Burimi: Bashkia Shkodër

Përpunoi: Grupi i auditimit

Eficienca dhe performanca e mbledhjes së të ardhurave nga tarifat e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve urbane nga Bashkia Shkodër paraqitet për të 4 vitet pozitive si për tarifat familjare ashtu dhe për subjektet tregtare, siç paraqitet edhe në tabelën e mësipërme.

Tabela nr. 22. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve më të ardhurat nga tarifat.

000/ lekë

Nr	Shpenzime/të ardhura	2020	2021	2022	2023
1	Shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)	131,593	121,313	183,173	187,659
2	Të ardhurat nga tarifat e pastrimit	<b>149,117</b>	<b>157,588</b>	<b>183,336</b>	<b>184,425</b>
3	Diferenca e mbulimit në lekë (1-2)	<b>+17,524</b>	+36,275	<b>+163</b>	<b>-3,234</b>
4	Diferenca e mbulimit në % (1-2)	<b>113%</b>	<b>130%</b>	<b>100%</b>	<b>98%</b>

Burimi: Bashkia Shkodër.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Bashkia Shkodër në vitet 2020 dhe 2021 ka tejkaluar mbulimin e kostos e shërbimeve për menaxhimin e mbetjeve urbane me të ardhurat e mbledhura nga tarifat e menaxhimit të mbetjeve, në respektim të parimit *ndotësi pagan*<sup>32</sup>. Në vitin 2022 ka mbuluar të gjithë koston e

<sup>29</sup> Ligji nr. 139, datë 17.12.2015, Për Vetëqeverisjen Vendore”.

<sup>30</sup> Ligjit nr.68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore

<sup>31</sup> VKM Nr. 418, datë 25.6.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”

<sup>32</sup> Pika 1, neni 20, ligji nr.10 463, datë 22.9.2011” Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

menaxhimit të mbetjeve me tarifën e mbledhura. Në vitin 2023 kostoja e menaxhimit të mbetjeve është mbuluar në masën 98%<sup>33</sup> me të ardhurat nga tarifa.

***Bashkia Korçë ka mbuluar kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit***

Bashkia Korçë ka miratuar taksat dhe tarifave vendore për vitet 2020 – 2023.<sup>34</sup> Për të katër këto vite tarifën e menaxhimit të mbetjeve urbane kanë qenë të njëjta dhe nuk janë ndryshuar si për qytetin e Korçës ashtu edhe për 8 njësitë administrative. Tarifa për familjet e qytetit ka qenë 3,800 lekë në vit, ndërsa për familjet në njësitë administrative 1,500 lekë në vit dhe për subjektet e ndryshme tregtare dhe institucione nga 20,000 lekë deri në 110,000 lekë në vit. Bazuar në këto tarifa dhe në numrin e familjeve dhe të subjekteve tregtare, janë planifikuar të ardhurat për mbulimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve për të gjithë territorin e bashkisë.

Tabela nr. 23. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit të Bashkisë Korçë.

Tarifat	Viti 2020			Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
	Plan 000/Lekë	Fakt 000/Lekë	%	Plan 000/Lekë	Fakt 000/Lekë	%	Plan 000/Lekë	Fakt 000/Lekë	%	Plan 000/Lekë	Fakt 000/Lekë	%
Familjet	86,667	77,327	89	90,261	82,404	91	93,562	82,557	88	94,906	76,067	80
Bizneset	104,601	71,179	68	105,618	78,490	74	104,665	77,458	74	131,040	79,833	61
<b>Totali</b>	<b>191,268</b>	<b>148,506</b>	<b>78</b>	<b>195,879</b>	<b>160,894</b>	<b>82</b>	<b>198,227</b>	<b>160,015</b>	<b>81</b>	<b>225,946</b>	<b>155,900</b>	<b>70</b>

Burimi: Bashkia Korçë.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Siç shihet, niveli i realizimit të të ardhurave nga mbledhja e tarifës, në vitin 2020 është rreth 78%, në vitin 2021 rreth 82%, në vitin 2022 rreth 81% dhe në vitin 2023 rreth 70%. Peshën më të madhe të mos realizimit e ka mos mbledhja e tarifës nga subjektet e tregtare që shkon nga 68% në vitin 2020, në 74% në vitin 2021, në 74% në vitin 2022 dhe në 61% në vitin 2023. Megjithatë mbledhja e tarifës nga abonentët familjarë paraqitet në nivel të kënaqshëm: në vitin 2020 rreth 89%, në vitin 2021 rreth 91%, në vitin 2022 rreth 88% dhe në vitin 2023 rreth 80%, në mosrealizim e kësaj tarife ka ndikuar mos mbledhja e tarifave në të 8 (tetë) njësitë administrative.

Tabela nr. 24. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve më të ardhurat nga tarifën.

000/ lekë					
Nr	Shpenzime/të ardhura	2020	2021	2022	2023
1	Shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)	102,621	132,653	114,899	135,061
2	Të ardhurat nga tarifën e pastrimit	148,506	160,894	160,015	155,900
3	Diferenca e mbulimit në lekë (1-2)	<b>+45,885</b>	<b>+28,241</b>	<b>+45,116</b>	<b>+20,839</b>
4	Diferenca e mbulimit në % (1-2)	<b>145%</b>	<b>121%</b>	<b>139%</b>	<b>115%</b>

Burimi: Bashkia Korçë.

Përpunoi: Grupi i auditimit

***Bashkia Durrës nuk ka mbuluar kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara.***

Bashkia Durrës ka përcaktuar tarifën e pastrimit të mbetjeve të qytetit të Durrësit dhe të 6 njësiteve administrative për periudhën 2020 - 2023.<sup>35</sup> Tarifa për familjet në vitet 2020 dhe 2021 ka qenë 2,300 lekë në vit për familjet e qytetit dhe 500 lekë në vit për familjet në njësitë administrative. Për

<sup>33</sup> Për vitin 2023 nuk është mbuluar 100% kosto për shkak të rritjes së shpenzimeve nga rritja e tarifës që paguan bashkia Shkodër për depozitimin e mbetjeve në lëndfillin e Bushatit.

<sup>34</sup> VKB Nr. 160, dt.25.11.2019, VKB Nr. 139, dt.11.12.2020, VKB Nr. 137, dt. 25.11.2021 dhe Nr.168, dt.24.11.2022, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Korçë".

<sup>35</sup> VKB nr. 160 datë 23.12.2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2022, i ndryshuar

subjektet e ndryshme tregtare, tarifat shkojnë nga 500 lekë deri në 70,000 lekë në vit. Ndërsa për vitet 2022 dhe 2023 kemi një rritje të nivelit të tarifave: për familjet në qytet ka qenë 3,500 lekë në vit, për familjet në njësitë administrative 1,500 lekë në vit. Për subjektet e ndryshme tregtare, tarifat shkojnë nga 5,000 lekë deri në 150,000 lekë në vit. Sipas VKB-ve për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Durrës, Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Durrës është ngarkuar, në rolin e agjentit tatimor, për mbledhjen e tarifës së pastrimit për kategorinë “familje” duke përfuturuar 2 % të të ardhurave të arkëtuara nga kjo tarifë. Për kategoritë e bizneseve janë ngarkuar strukturat e brendshme të Bashkisë Durrës. Bazuar në këto tarifa dhe në numrin e familjeve dhe të subjekteve tregtare, janë planifikuar të ardhurat për mbulimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve për të gjithë territorin e bashkisë, si më poshtë.

Tabela nr. 25. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit të Bashkisë Durrës.

Zerat	Viti 2020 000/lekë			Viti 2021 000/lekë			Viti 2022 000/lekë			Viti 2023 000/lekë		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
<b>Familjet</b>	109,110	16,799	15	109,190	67,966	62	130,000	42,502	33	160,000	71,920	45
<b>Bizneset</b>	147,144	95,914	65	147,144	137,447	93	180,000	144,049	80	190,000	169,549	89
<b>Totali</b>	<b>256,254</b>	<b>112,713</b>	<b>44</b>	<b>256,334</b>	<b>205,414</b>	<b>80</b>	<b>310,000</b>	<b>186,552</b>	<b>60</b>	<b>350,000</b>	<b>241,469</b>	<b>69</b>

Burimi Bashkia Durrës.

Përpunoi Grupi i auditimit.

Nga analiza e të dhënave evidentohet se, norma e realizimit të të ardhurave nga mbledhja e tarifave është ulët: në vitin 2020 është rreth 44%, në vitin 2021 rreth 80%, në vitin 2022 rreth 60% dhe në vitin 2023 rreth 69%. Në nivel disi më të kënaqshëm paraqitet mbledhja e tarifës nga subjektet tregtare.

Numri i abonentëve për tarifën e pastrimit për kategorinë “familje” është 40.776, të cilët kanë kontratë me UKD dhe janë banorë të Bashkisë Durrës të regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile. Ndërkohë, 34,364 abonentë familjarë kanë kontratë me UKD, banojnë në Bashkinë Durrës dhe nuk janë të regjistruar në Gjendjen Civile. Në total numri i abonentëve familjarë për vitin 2023 ka qenë 75,140. Të gjithë këta abonentë janë të ngarkuar me tarifën e pastrimit në përputhje me VKB-të përkatëse për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Durrës. Bashkia Durrës, nisur edhe nga rekomandimet e auditimeve të mëparshme të KLSH-së, ka arritur të rrisë numrin e abonentëve familjarë nga 23,000 në rreth 75,000 duke krijuar kështu edhe një regjistër të abonentëve familjarë. Pra mbështetur në trefishimin e numrit të abonentëve si dhe në rritjen e tarifave nga 23 mijë lek/vit në 35 mijë lek/vit, Bashkia Durrës planifikoi vlerë më të mëdha nga të ardhurat e krijuara nëpërmjet tarifës së pastrimit. Pavarësisht rritjes së numrit të abonentëve familjarë, UKD, për vitin 2020 ka arkëtuar 16,799,288 lekë ose rreth 15% të faturimit sipas planit; për vitin 2021 ka arkëtuar 67,965,930 lekë ose rreth 62%; për vitin 2022 ka arkëtuar 40,502,926 lekë ose rreth 33% dhe për vitin 2023 ka arkëtuar 43,424,447 lekë ose rreth 27%. Në përgjigjet zyrtare, Bashkia Durrës sqaron se nga ana e agjentit tatimor (UKD) nuk ka informacion të saktë mbi vlerën e mbledhur nga UKD të tarifës së pastrimit por vetëm mbi vlerën që UKD i ka përcjellë Bashkisë Durrës. Bashkia është mjaftuar vetëm me akt-rakordimet mujore të UKD për xhirimin e lekëve që i ka bërë bashkisë, por pa kërkuar dhe rakorduar saktësisht se, sa abonentë kanë paguar tarifën dhe sa është vlera e detyrimi të mbetur që UKD nuk ia ka derdhur Bashkisë.

Tabela nr. 26. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve më të ardhurat nga tarifat<sup>36</sup> 000/lekë

Nr	Shpenzime/të ardhura	2020	2021	2022	2023
1	Shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)	370,153	437,426	964,074	961,564
2	Të ardhurat nga tarifat e pastrimit	112,713	205,414	186,552	203,658
3	Diferenca e mbulimit në lekë (1-2)	-257,440	-232,012	-777,522	-757,906
4	Diferenca e mbulimit në % (1-2)	30%	50%	19.3%	21.2%

Burimi: Bashkia Durrës. Përpunoi: KLSH

<sup>36</sup> Të dhënat e vitit 2023 janë sipas evidencave të muajit nëntor, pa përfshirë muajin dhjetor

Siç tregohet edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme, Bashkia Durrës nuk ka mbuluar me të ardhurat e krijuara koston e shërbimeve për menaxhimin e mbetjeve urbane. Diferenca e kostos është financiar nga buxheti i shtetit nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm, respektivisht 257,440 mijë lekë në vitin 2020 dhe 232,012 mijë lekë në vitin 2021. Në total, granti i pakushtëzuar për vitin 2020 ka qenë në shumën 842,614,000 lekë<sup>37</sup>, ndërsa për vitin 2021, në shumën 848,218 mijë lekë<sup>38</sup>. Për vitin 2022 Bashkia Durrës ka përfituar grant të pakushtëzuar në shumën 877,905 mijë lekë dhe në vitin 2023 në shumën 1,053,486 mijë lekë. Veç këtyre, Bashkia Durrës ka përfituar edhe grant të kushtëzuar për mbulimin e kostove të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, respektivisht: në vitin 2022 në shumën 221,600 mijë lekë<sup>39</sup> dhe në vitin 2023 në shumën 236,000 mijë lekë<sup>40</sup>.

Referuar tabelës së mësipërme nr. 26, diferenca në lekë e krijuar midis të ardhurave nga tarifa e pastrimit kundrejt shpenzimeve totale të menaxhimit të mbetjeve urbane ka qenë respektivisht 777,522,000 lekë në vitin 2022 dhe 757,906,000 lekë në vitin 2023. Për vitet 2022 dhe 2023, Bashkia Durrës përveç grantit të kushtëzuar ka përdorur edhe grantin e pakushtëzuar për të mbuluar kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane. Nga granti i pakushtëzuar janë përdorur rreth 556 milionë lekë për vitin 2022 dhe rreth 522 milionë lekë për vitin 2023. Thënë ndryshe, Bashkia Durrës, në vitin 2022 ka përdorur 63 % të grantit të pa kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe në vitin 2023 49.5 % të tij.

***Bashkia Vlorë për vitet 2020 dhe 2022 nuk ka mbuluar kostot e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara***

Për vitet 2020-2023, Bashkia Vlorë ka miratuar taksat dhe tarifave vendore.<sup>41</sup> Për të katër vitet, tarifat e menaxhimit të mbetjeve urbane nuk janë ndryshuar si për qytetin e Vlorës ashtu edhe për 5 njësitë administrative të saj. Tarifa për familjet e qytetit, ka qenë 2,400 lekë në vit, për familjet e Njësisë Administrative Orikum ka qenë 1,800 lekë në vit, për familjet e njërive të tjera 876 lekë në vit. Për subjektet e ndryshme tregtare dhe institucionet, tarifat kanë qenë nga 876 lekë deri në 70,000 lekë në vit. Në bazë të këtyre tarifave, Bashkia ka planifikuar të ardhurat që do të realizohen për mbulimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, si më poshtë:

Tabela nr. 27. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga tarifa e pastrimit të Bashkisë Vlorë

Tarifat	Viti 2020 000/leke			Viti 2021 000/leke			Viti 2022 000/leke			Viti 2023 000/leke		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Familjet	146,153	38,437	26	152,928	99,936	65	152,880	104,960	69	149,971	60,343	40
Bizneset	77,173	69,037	89	78,540	86,153	110	82,404	103,010	125	106,946	108,219	102
<b>Totali</b>	<b>223,326</b>	<b>107,474</b>	<b>48</b>	<b>231,468</b>	<b>186,090</b>	<b>80</b>	<b>235,284</b>	<b>207,970</b>	<b>88</b>	<b>256,917</b>	<b>168,562</b>	<b>66</b>

Burimi Bashkia Vlorë.

Përpunoi KLSH

Sikurse mund të vërehet në tabelën nr. 27, niveli i mbledhjes së të ardhurave është i ulët. Në vitin 2020 mbledhja e të ardhurave nga tarifa e pastrimit është realizuar në nivelin 48 %, në vitin 2021 në 80%, në vitin 2022 në 88% dhe në vitin 2023 në 66%. Nëse do të vërejmë mbledhjen e të ardhurave sipas kategorive, subjektet e biznesit paraqiten në nivel më të kënaqshëm se sa abonentët familjarë.

<sup>37</sup> Ligji Nr.88/2019 “Për buxhetin e shteti të vitit 2020”

<sup>38</sup> Ligji Nr. 137/2020 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021”

<sup>39</sup> Ligji Nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”

<sup>40</sup> Ligji Nr. 84/2022 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”

<sup>41</sup> VKB Vlorë me Nr. 109, datë 27.11.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë” i ndryshuar me VKB nr. 79, datë 02.12.2021 dhe VKB nr.95 datë 23.12.2022

Tabela nr. 28. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve më të ardhurat nga tarifat 000/ lekë

Nr	Shpenzime/të ardhura	2020	2021	2022	2023
1	Shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane (grumbullim, transportim, pastrim, depozitim)	268,845	182,653	340,300	132,312
2	Të ardhurat nga tarifat e pastrimit	107,474	186,090	207,970	168,562
3	Diferenca e mbulimit në lekë (1-2)	-161,371	+3,437	-132,330	+36,250
4	Diferenca e mbulimit në % (1-2)	40%	102%	61%	127%

Burimi: Bashkia Vlorë.

Përpunoi: KLSH

Bashkia Vlorë për vitin 2020 dhe 2022 nuk ka mbuluar me të ardhurat e krijuara koston e menaxhimit të mbetjeve urbane. Në vitin 2020, me të ardhurat e krijuara nga mbledhja e tarifës së pastrimit është mbuluar vetëm 40% e kostos. Diferenca e shpenzimeve prej 161,371 lekë është financuar nga buxheti i shtetit nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm që i është dhënë në shumën 543,546 mijë lekë<sup>42</sup> (sipas formulës), duke cënuar kështu nivelin e shpenzimeve të përgjithshme që i nevojiten bashkisë për kryerjen e aktiviteteve e tjera të saj. Për vitin 2022, Bashkia Vlorë ka mbuluar 61% koston e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat nga tarifat. Diferenca e kostos prej 132,330 mijë lekë, është mbuluar tërësisht nga grantet buxhetore që i janë dhënë bashkisë konkretisht, nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm që i është dhënë në shumën 125,574 mijë lekë dhe nga grandit dhe nga grandit e dhënë enkas për menaxhimin e mbetjeve në shumën 22,600 mijë lekë<sup>43</sup>.

Për vitet 2021 dhe 2023 Bashkia Vlorë ka arritur të mbulojë shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve me të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit. Konkretisht, për vitin 2021 është tejkaluar me 2%, dhe në vitin 2023 është tejkaluar me 9%. Nëse koston së menaxhimit të mbetjeve do t'i shtonim edhe tarifën e depozitimit në lëndfill, atëherë niveli i shpenzimeve do të rritej edhe më tepër.

### **Bashkitë subjekt auditimi nuk marrin në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën ato jetojnë gjatë përlogaritjes së tarifës së pastrimit.**

Duke marrë shkas shembullin e një bashkie të vogël në Itali<sup>44</sup>, është e rëndësishme të evidentohet se tarifa e menaxhimit të mbetjeve përlogaritet ndryshe me vendin tonë. Më konkretisht, parakusht për lindjen e detyrimit monetar është posedimi i një prone, qoftë ajo ndërtesë apo truall, e cila mund të gjenerojë mbetje urbane<sup>45</sup>. Sipas kësaj praktike, bëhet diferencimi midis banorëve dhe bizneseve. Në kategorinë e banorëve evidentohen veçmas rezidentët dhe jo rezidentët. Banorët të cilët janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile të bashkisë, por që momentalisht nuk janë rezident, nuk u lind detyrimi për të paguar tarifën e menaxhimit të mbetjeve. Tarifa e menaxhimit të mbetjeve paguhet vetëm nga banorët rezident dhe bizneset. Përlogaritja e vlerës së tarifës kryhet duke pasur parasysh sipërfaqen e banesës dhe numrin e individëve që janë rezidentë në atë banesë. Kjo do të thotë që banesat me sipërfaqe më të madhe, si edhe me numër më të madh individësh rezident do të paguajnë tarifë më të lartë për menaxhimin e mbetjeve.<sup>46</sup>

Bashkitë subjekt auditimi, kanë ngarkuar Shoqëritë “Ujësjetës – Kanalizime” respektive për ta mbledhur tarifën e pastrimit të fatura e ujit të ndarë në mënyrë të barabartë për çdo muaj të vitit ushtrimor. Pavarësisht se tarifa mund të ndryshojë nga njëra bashki në tjetrën, të gjitha bashkitë subjekt auditimi kanë të përcaktuar të njëjtën tipologji sa i përket kategorizimit të tarifës së

<sup>42</sup> Ligji Nr.88/2019 “Për buxhetin e shteti të vitit 2020”. Transferata e Pakushtëzuar (TP) rregullohet nga Ligji nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i cili përcakton madhësinë dhe mënyrën e ndarjes për NJVQV. Si rregull i përgjithshëm, transferata e pakushtëzuar ka për qëllim t’u sigurojë njësive të vetëqeverisjes vendore diferencën mes koston së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal).

<sup>43</sup> Ligji Nr. 115/2021 “Për buxhetin e shteti të vitit 2022”

<sup>44</sup> Comune di Cortona.

<sup>45</sup> Neni 4, Regolamentoo “TARI” (Tributo Diretto slla Copertura dei Costi Relativi al Servizio di Gestione dei Rifiuti)

<sup>46</sup> Neni 14, Regolamentoo “TARI” (Tributo Diretto slla Copertura dei Costi Relativi al Servizio di Gestione dei Rifiuti).

<https://www.gazzettaufficiale.it/eli/id/1999/06/04/099G0235/sg>

pastrimit. Kategoritë kryesore që ato kanë përcaktuar janë “familja”, biznesi privat (i madh e i vogël) si dhe entet dhe institucionet publike. Në kategorinë “familja” janë parashikuar disa përjashtime për grupe të caktuara si për shembull familjet me ndihmë ekonomike, pensionistë, veteranë, invalidë etj. Ndryshe nga rasti i Italisë që trajtuam më sipër, në Shqipëri nuk merren në konsideratë madhësia e familjes si dhe sipërfaqja e banimit në të cilën jeton familja apo edhe sipërfaqja në të cilën biznesi kryen aktivitetin e tij. Pra, familje me më shumë se 5 apo 6 anëtare paguajnë njësoj me një familje me 2 apo 3 anëtarë dhe kjo nuk është e drejtë sepse një familje me 2 apo 3 anëtare nuk gjeneron të njëjtën sasi mbetjesh me një familje me 5 apo 6 anëtare apo edhe më shumë. Gjithashtu, një familje që jeton në një sipërfaqe prej 60 m<sup>2</sup>, nuk duhet të paguajë njësoj me një familje që jeton në sipërfaqe më të mëdha. I njëjti diskutim shtrohet edhe për bizneset. Pavarësisht se tarifat për bizneset vendosen sipas kategorisë së tyre, nuk merret në konsideratë sipërfaqja që këto biznese ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

#### **Fact box**

Që nga viti 2005, për të promovuar grumbullimin e ndarë të mbetjeve në burim, Sardinja ka përshtatur tarifën e vendosur për menaxhimin e mbetjeve bazuar në nivelin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të arritur nga çdo bashki. Për shembull, nëse niveli i diferencimit të mbetjeve arrinte 50% - 60% aplikohet një lehtësim tatimor prej 20%. Nëse grumbullimi i diferencuar ishte mbi 60 % atëherë taksapaguesit përfitonin një lehtësim tarifor prej 40 %. Megjithatë, nëse grumbullimi i diferencuar do të ishte nën 50 % (ose 40 % në varësi të numrit të banorëve të bashkisë) aplikohet një gjobë prej 5,16 euro/ton shtesë.<sup>47</sup>

#### **Gjetje nga auditimi 1:**

Bashkia Durrës për periudhën 2020-2021 nuk ka arritur të mbulojë shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane me të ardhurat e gjeneruara nga tarifa e pastrimit. Të ardhurat e krijuara nga mbledhja e tarifës së pastrimit përgjatë periudhës 2020-2023 kanë qenë mesatarisht në nivelin 63 %. Megjithatë, edhe nëse do të arrihej mbledhja e tyre në nivelin 100 %, përsëri Bashkia Durrës nuk do të mund të mbulonte shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane. Për vitin 2020 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (112,713,000 lekë), Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 30 % të kostove totale të menaxhimin të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 257,440,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Për vitin 2021 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (205,414,000 lekë), Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 50 % të kostove totale të menaxhimin të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 232,012,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar.

Po kështu edhe për vitet 2022 dhe 2023 Bashkia Durrës nuk ka arritur të mbulojë kostot e menaxhimin të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara prej saj. Për këto dy vite, përveç grantit të pakushtëzuar, Bashkia Durrës është mbështetur edhe me grant të kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane. Për vitin 2022 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (186,552,000 lekë), si dhe grantit të kushtëzuar (221,600,000 lekë) Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 42 % të kostove totale të menaxhimin të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 557,000,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Për vitin 2023 nga të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit (203,658,000 lekë), si dhe grantit të kushtëzuar (236,000,000 lekë) Bashkia Durrës ka arritur të mbulojë vetëm 46 % të kostove totale të menaxhimin të mbetjeve urbane. Pjesa tjetër prej rreth 522,000,000 lekë është mbuluar nga granti i pa kushtëzuar. Përdorimi i grantit të pa kushtëzuar në mbulimin e shpenzimeve të menaxhimin të mbetjeve urbane riskon arritjen dhe mbulimin e aktiviteteve të tjera të Bashkisë Durrës që do të duheshin të mbuloheshin me anë të grantit të pa kushtëzuar.

<sup>47</sup> [https://www.eca.europa.eu/lists/ecadocuments/sr12\\_20/sr12\\_20\\_en.pdf](https://www.eca.europa.eu/lists/ecadocuments/sr12_20/sr12_20_en.pdf)

### **Gjetje nga auditimi 2:**

Bashkia Vlorë për vitet 2020 dhe 2022 nuk ka arritur të mbulojë shpenzimet e menaxhimit të mbetjeve urbane me të ardhurat e krijuara nga tarifa e pastrimit. Në vitin 2020, diferenca e kostos (161,371,000 lekë) është financuar nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm. Në vitin 2022, diferenca e kostos (132,330,000 lekë) është mbuluar tërësisht nga buxheti i shtetit nëpërmjet grantit të pakushtëzuar të përgjithshëm (125,574,000 lekë) dhe grantit të kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbane (22,600,000 lekë). Pra, për këtë vit, Bashkia Vlorë për menaxhimin e mbetjeve urbane ka përdorur të gjitha të ardhurat nga tarifa e pastrimit, grantin e kushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve dhe 87.4% të grantit të pakushtëzuar.

### **Gjetje nga auditimi 3:**

Ndryshe nga praktika e Italisë, bashkitë subjekt auditimi, në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit nuk marrin në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën familja jeton. Gjithashtu edhe për tarifën e vendosura për biznesin, ato nuk marrin në konsideratë sipërfaqen në të cilin biznesi ushtron aktivitetin e tij.

### **Konkluzione**

1. Për periudhën 2020-2023, Bashkia Durrës me të ardhurat e krijuara nuk ka mbuluar shpenzimet mbi menaxhimin e mbetjeve.
2. Bashkitë subjekt auditimi, gjatë përlllogaritjes së tarifës së pastrimit nuk marrin parasysh madhësinë e familjes, sipërfaqen e banimit të familjes si dhe ushtrimin të aktivitetit të biznesit. Kjo mënyrë e përlllogaritjes nuk lejon që kostot e menaxhimit të mbetjeve të shpërndahen në përpjesëtim të drejtë midis prodhuesve të mbetjeve.

#### **1.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të ngrenë grup pune për të analizuar tarifën e pastrimit për kategoritë e familjes dhe biznesit duke pasur në konsideratë madhësinë e familjes dhe sipërfaqen në të cilën ajo banon si dhe sipërfaqen në të cilën biznesi ushtron aktivitetin e tij.

**Në vazhdimësi**

#### **2.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Durrës dhe Vlorë të hartojnë dhe miratojnë një plan lokal të mirë detajuar për të rritur mbledhjen e tarifës së pastrimit, uljen e debitorëve dhe në bashkëpunim me Ndërmarrjet e Ujësjellës Kanalizime Durrës dhe Vlorë të rrisin arkëtimet e kësaj tarife.

**Dhjetor 2024**

### **4.2 A është hartuar dhe zbatuar baza ligjore e nënligjore për menaxhimin e mbetjeve urbane nga bashkitë Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë?**

#### **4.2.1 A kanë zbatuar subjektet nën auditim kuadrin ligjor e nënligjor mbi menaxhimin e mbetjeve?**

**Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë nuk kanë zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore mbi hartimin, miratimin dhe raportimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane.**

Çdo njësi e qeverisjes vendore harton planin vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për territorin që ka nën juridiksion, në përputhje me planin kombëtar dhe planin rajonal të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Referuar ligjit të menaxhimit të mbetjeve, bashkitë duhet të raportojnë çdo vit në këshillin e qarkut përkatës për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve në formatin e përcaktuar nga ministri. Planet vendore të menaxhimit të integruar të



mбетjeve të cilët duhet të miratohen nga këshilli bashkiak rishikohen dhe në rast se është e nevojshme përditësohen të paktën çdo gjashtë vjet.<sup>48</sup>

Bashkia Vlorë ka hartuar dhe miratuar Planin Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (i cili do të mbulojë periudhën 2023-2028), me mbështetje nga programi *Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta, Rajoni Vlorë*, në kuadër të asistencës së Qeverisë Gjermane përmes KfW-së, zbatuar nga *Infrastruktur & Umwelt, RWA dhe FLAG*.<sup>49</sup> Para kësaj periudhe, Bashkia Vlorë nuk ka pasur një plan të tillë. Mungesa e një plani vendor për menaxhimin e mbetjeve urbane për të gjithë periudhën para vitit 2023 nuk ka lejuar që objektivat kombëtare strategjike të transpozohen në nivel vendor. Në mungesë të një plani të tillë vështirësohet edhe më tej menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara nga më shumë se 6,600 biznese dhe rreth 140,000 banorë që operojnë dhe jetojnë në territorin e kësaj bashkie. E gjithë kjo situatë ka prodhuar efekte negative jo vetëm në mjedis dhe ekonomi por edhe në imazhin që duhet të pasqyrojë një qytet bregdetar aq i rëndësishëm për sektorin e turizmit dhe peshkimit si Vlorë. Ky impakt negativ amplifikohet edhe më tepër gjatë sezonit të verës kur popullsia e Vlorës shumëfishohet e për pasojë edhe volumi i mbetjeve.

Bashkia Shkodër ka hartuar dhe miratuar Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane për periudhën 2017-2022. Ky plan mundëson orientimin strategjik për të ardhmen dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis aktorëve të ndryshëm për menaxhimin e mbetjeve në nivel lokal. Aktualisht Bashkia Shkodër ka ngritur grupin e punës me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë për rishikimin e Planit lokal të menaxhimit të mbetjeve urbane për vitin 2024-2028. Me përfaqësues nga Ndërmarrja e shërbimeve dhe punëve publike dhe Drejtoria e Mjedisit e Bashkisë Shkodër. Bashkia në këtë rast asistohet nga projekti Bashki të Forta financuar nga *Swiss Agency of Development and Cooperation*.

Bashkia Durrës pavarësisht se ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve<sup>50</sup> që prej vitit 2010 (i cili mbulon periudhën 2010-2025), ai nuk ka qenë i miratuar. Mos miratimi i Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Durrës sjell të njëjtat pasoja si në rastin e Vlorës të përshkruar më sipër. Duhet theksuar se referuar edhe kuadrit ligjor mbi menaxhimin e mbetjeve, plane të tilla duhet të përditësohen çdo 6 vjet veçanërisht në raste të ndryshimeve ligjore të rëndësishme. Kujtojmë se Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” është miratuar 1 vit pas hartimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve (PLMM) të Bashkisë Durrës. Po ashtu, edhe Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve janë hartuar më vonë se PLMM të Bashkisë Durrës, ndaj, lind nevoja që Bashkia Durrës të hartojë dhe miratojë një Plan të ri lidhur me menaxhimin e mbetjeve.

Bashkia Korçë me anë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 48 datë 20.03.2023 ka miratuar Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Korçë i cili do të mbulojë periudhën 2023-2028. Përpara tij ka qenë në fuqi Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për periudhën 2018-2022, i miratuar me VKB nr.1, dt.09.02.2018. Lidhur me raportimet zyrtare në Këshillin e Qarkut Korçë mbi zbatimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane, raportimi i parë është bërë në vitin 2023 me shkresën nr.7901 prot. datë 10.10.2023.

### **Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë nuk kanë shoqëruar planet vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane me Vlerësimin Strategjik Mjedisor.**

Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor<sup>51</sup> ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasoja të mundshme negative në mjedis. Procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor i nënshtrohet hartimi i të gjitha planeve dhe

<sup>48</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 12, 13.

<sup>49</sup> <https://konsultimivendor.al/wp-content/uploads/2023/04/PVMIM-Vlore-30.03.2023.pdf>

<sup>50</sup> <https://durrës.gov.al/ngarkime/uploads/2014/06/BASHKIADURRES.pdf>

<sup>51</sup> Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”

programeve, ndër të tjera edhe për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë planet e programet e financuara nga institucione të huaja.<sup>52</sup>

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) nënkupton hartimin e një raporti të posaçëm për pasojat në mjedis të një plani apo programi, realizimin e konsultimeve me grupet e interesit si dhe marrjen në konsideratë të rezultateve të raportit dhe konsultimeve në marrjen e vendimit përfundimtar për miratimin e tij.

Në ligjin për mbrojtjen e mjedisit përcaktohet momenti kur projekt-plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve i nënshtrohet VSM-së.<sup>53</sup> Në parim, Këshilli Bashkiak para se të miratojë Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve, merr në shqyrtim rezultatet e vlerësimit strategjik mjedisor si dhe mendimet e autoriteteve ose të institucioneve përkatëse. Megjithatë, nëse planet lokale të menaxhimit të mbetjeve parashikojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel vendor dhe/apo ndryshime jo thelbësore krahasuar me planin e kaluar, është MTM institucioni që vendos nëse është e nevojshme që PLMM të shoqërohet me VSM. Pra, në kushtet kur bashkitë subjekt auditimi nuk i kanë shoqëruar asnjëherë planet lokale të menaxhimit të mbetjeve me VSM, nevojitet që ato t'i drejtohen MTM-së për të vlerësuar nëse ky proces është i domosdoshëm rast pas rasti.

### **Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë nuk kanë realizuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime kompostimi**

Referuar ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, njësitë e qeverisjes vendore, brenda kompetencave të tyre, nxisin grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime kompostimi dhe tretje të mbetjeve bio. Referuar Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, rreth 50 % të mbetjeve në Shqipëri janë mbetje bio të cilat gjenerohen nga kopshtet e shtëpive dhe parqet, mbetjet ushqimore dhe të gatimit nga shtëpitë, restorantet, kateringju dhe dyqanet e shitjes me pakicë, si dhe mbetjet e ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimeve. Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve, parashikon një rritje të rikuperimit të materialeve nga mbetjet bashkiake përmes riciklimit, kompostimit dhe shndërrimit të energjisë prej 55 %, deri në vitin 2020 dhe 75 %, deri në vitin 2025.<sup>54</sup> Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve organike dhe materialeve të riciklueshme kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara ligjore për mbrojtjen mjedisore. Grumbullimi i diferencuar dhe aktivitetet e mëtejshme të kompostimit dhe riciklimit ndihmojnë në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe në reduktimin e ndikimeve mjedisore negative të vend depozitimeve.

Me anë të VKM-së nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre” janë parashikuar masat që duhet të merren nga njësitë e vetqeverisjes vendore lidhur me:

- rregullat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio për qëllime trajtimi;
- trajtimi i mbetjeve bio, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit;
- hapat dhe afatet për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio;
- procedurat për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio.

Afati për grumbullimin në mënyrë të diferencuar të mbetjeve bio, nga njësitë e qeverisjes vendore, është brenda vitit 2017 për bashkitë qendër qarku, ndërsa për bashkitë e tjera brenda vitit 2018.<sup>55</sup>

Deri më sot, siç është thënë edhe në nen pyetjen e parë audituese, për të gjitha bashkitë subjekt auditimi nuk kryhet procesi i kompostimit. Objektivi kryesor i VKM-së nr. 608, datë 17.9.2014 që do të duhej të ishte arritur nga njësitë e qeverisjes vendore mbi pakësimin e sasisë së mbetjeve bio që shkojnë në lëndfill është ulja në masën 50% të peshës totale të mbetjeve bio, të prodhuara në vitin 2014, jo më vonë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Pra, deri në vitin 2021 të gjitha

<sup>52</sup> Ligji nr. 91/2013 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, neni 2 pika 5.

<sup>53</sup> Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 24 pika 1, a.

<sup>54</sup> Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, fq. 50

<sup>55</sup> VKM nr. 608, datë 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”, pika 4.

bashkitë në vendin tonë (përfshirë edhe 4 bashkitë subjekt i këtij auditimi) do të duhej të përgjysmonin sasinë e mbetjeve bio të cilat depozitohen në lëndfill. Gjithashtu në këtë VKM përcaktohen në mënyrë të detajuar sistemet dhe koshat që duhet të instalohen për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio.

#### *Grumbullimi i diferencuar i mbetjeve*

Grumbullimi i diferencuar nënkupton grumbullimin ku një rrymë mbetjesh ndahet në mënyrë të veçantë sipas llojit dhe natyrës në mënyrë që të lehtësohet trajtimi i këtyre mbetjeve.<sup>56</sup> Njësitë e qeverisjes vendore grumbullojnë në mënyrë të diferencuar mbetjet, brenda 31 dhjetorit 2018, të paktën për këto rryma mbetjesh: letër, metal, plastikë dhe qelq.<sup>57</sup> Pra, sipas këtij kriteri, bashkitë subjekt i këtij auditimi, ashtu si edhe të gjitha bashkitë e tjera të vendit tonë do të duhej të kishin aplikuar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve veçanërisht për mbetjet e krijuara të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit. Kujtojmë se sipas Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, këto katër rryma të mbetjeve përbëjnë rreth 34 % të volumit total të mbetjeve urbane që gjenerohen. Edhe pse kanë kaluar më shumë se 5 vjet nga afati i përcaktuar në ligjin e menaxhimit të mbetjeve, bashkitë subjekt auditimi nuk kanë arritur ta respektojnë këtë objektiv.

#### **Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë e Korçë nuk kanë realizuar ripërdorimin/riciklimin e letrës, metalit, plastikës dhe qelqit**

VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim” ndër të tjera ka përcaktuar edhe objektiva specifike që duhet të arrihen nga njësitë e qeverisjes vendore për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve sipas peshës së tyre si më poshtë:

letër/karton (60%);

metal (50%);

plastikë (22.5%);

qelq (60%).

Pra, për letrën/kartoni NJVQV-të duhet të ripërdorin/riciklojnë 60 % e sasisë së gjeneruar, për metalet 50 %, për plastikën 22.5 % dhe për qelqin 60%. Nisur nga situata aktuale në të cilën gjenden të gjitha bashkitë subjekt auditimi, rezulton se në mungesë të kryerjes së procesit të riciklimit nuk janë arritur objektivat e vendosura nga VKM e sipërcituar për të katër rrymat.

#### **Gjetje nga auditimi 1:**

Bashkia Shkodër, që prej vitit 2023 e deri më sot nuk ka një Plan Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu edhe Bashkia Durrës, pavarësisht se ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve për periudhën 2010-2025, nuk e ka miratuar me VKB. Për më tepër, periudha e gjatë e mbulimit të këtij plani dhe ndryshimet e rëndësishme të politikave dhe kuadrit ligjor kombëtar të menaxhimit të mbetjeve si dhe organikës së Bashkisë Durrës e bëjnë këtë plan të pa zbatueshëm.

#### **Gjetje nga auditimi 2:**

Për periudhën 2020-2023, Bashkitë Shkodër, Durrës dhe Vlorë nuk kanë raportuar në Këshillin e Qarkut përkatës për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të mbetjeve urbane me përjashtim të Bashkisë Korçë e cila ka raportuar vetëm në vitin 2023.<sup>58</sup>

#### **Gjetje nga auditimi 3:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk i kanë shoqëruar Planet e Menaxhimit Lokal me VSM referuar ligjit për vlerësimin strategjik mjedisor, ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve

<sup>56</sup> Direktiva 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Mbi mbetjet”, neni 3 pika 11

<sup>57</sup> Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, neni 18, pika 3

<sup>58</sup> Shkresa me nr. 7901 prot. datë 10.10.2023.

dhe ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në cilësinë e autoritetit kompetent vendos nëse një Bashki duhet t'i nënshtrohet apo jo procesit të vlerësimit strategjik mjedisor gjatë hartimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.

#### **Gjetje nga auditimi 4:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë marrë asnjë masë për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio duke mos mundur kështu procesin e kompostimit dhe tretjes së këtyre mbetjeve. Afati maksimal për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve organike ka qenë viti 2018. Sa i përket reduktimit të mbetjeve bio, deri në vitin 2021 bashkitë subjekt i këtij auditimi do të duhej të reduktonin me 50 % sasinë e mbetjeve bio (krahasuar me 2014) që depozitohen në lëndfill. Duke pasur në konsideratë që mbetjet bio përbëjnë gjysmën e totalit të mbetjeve që gjenerohen nga bashkitë mund të themi se nëse do të arrihej objektivi i përcaktuar mbi reduktimin e mbetjeve bio bashkitë do të mund të kursenin afërsisht rreth ¼ e tarifës së depozitimit total të mbetjeve në lëndfill.

#### **Gjetje nga auditimi 5:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë arritur të realizojnë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve për rrymat letër, plastikë, metal e qelq duke mos arritur një ndër objektivat kryesorë të ligjit të menaxhimit të integruar të mbetjeve. Në këtë mënyrë Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë nuk kanë arritur ripërdorimin/riciklimin e mbetjeve të letrës, metalit, plastikës dhe qelqit sipas objektivit të përcaktuar në VKM-në nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”, Kreu V, pika 1.

#### **Konkluzione**

1. Mos përmbushja e detyrimeve ligjore nga bashkitë subjekt auditimi lidhur me:
  - Hartimin dhe miratimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane;
  - Raportimin në Këshillat e Qarqeve mbi zbatimin e planeve vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane;
  - Realizimin e procesit të VSM për të shoqëruar planet vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane;
  - Objektivat mbi grumbullimin e diferencuar të mbetjeve bio si dhe riciklimit të rrymave letër, karton, plastikë e qelq.dëshmon një mungesë fokusi të këtyre institucioneve në drejtim të menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane.

#### **1.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Durrës dhe Shkodër të marrin masa të menjëhershme për hartimin dhe miratimin me VKB të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane respektive.

**Brenda vitit 2024**

#### **2.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë të marrin masa dhe të raportojnë çdo vit në Këshillin e Qarkut përkatës lidhur me zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve.

**Në vazhdimësi**

#### **3.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Vlorë dhe Korçë të marrin masa që projekt-planet vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane që do të hartojnë dhe miratojnë në të ardhmen t'i nënshtrohen kryerjes së procesit të vlerësimit strategjik mjedisor.

**Në vazhdimësi**

#### 4.1 Rekomandimi:

Bashkitë Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë të marrin masa të fillojnë procesin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për ripërdorimin/riciklimin e letrës, plastikës, metalit dhe qelqit si dhe kryerjen e procesit të kompostimit lidhur me mbetjet bio.

**Brenda vitit 2024**

#### 4.2.2 A kanë vendosur dhe zbatuar bashkitë objektivat e duhura në funksion të kuadrit ligjor?

Çështja e menaxhimit të mbetjeve është një nga sfidat më të mëdha mjedisore jo vetëm në Shqipëri, por edhe në nivel ndërkombëtar. Ndaj, hartimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të mbetjeve merr një rëndësi të veçantë. Direktiva e BE-së dhe ligji jonë mbi menaxhimin e mbetjeve (i cili ka transpozuar Direktivën e BE-së) kërkojnë që bashkitë të përgatisin planet e menaxhimit të mbetjeve në nivel lokal. Grupi i auditimit përtej faktit nëse bashkitë subjekt auditimi kanë hartuar/miratur planet vendore të menaxhimit të mbetjeve (çështje e trajtuar më sipër) u fokusua edhe në përmbajtjen e këtyre planeve duke përdorur si udhërrëfyes dhe praktikë e mirë një studim ose më saktë punim shkencor<sup>59</sup> të kryer nga Universiteti i Xhenova në Itali. Ky studim hulumton mbi kërkime të ndryshme të BE-së lidhur me udhëzime gjatë përgatitjes së një Plani të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane, një plan që mundëson arritjen e një sistemi të integruar të mbetjeve, në të cilin fazat e ndryshme të menaxhimit janë të koordinuara dhe të integruara në kontekstin e të gjithë procesit. Ky punim shkencor është fokusuar dhe ka marrë si rast studimi Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë së Xhenovas në Itali. Së pari duhet theksuar se për përgatitjen e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë së Xhenovas krahas administratës publike janë përfshirë Universiteti Publik i Xhenovas si dhe të gjithë aktorët e sektorit të mbetjeve. Studimi ka konsistuar në 5 faza thelbësore që duhen marrë në konsideratë në përgatitjen e një plani të mirë të menaxhimit të mbetjeve të cilat janë:

1. Sfondi;
2. Diagnostifikimi i veprës së artit: “*status quo*” dhe analiza;
3. Planifikimi ose pjesa operacionale;
4. Aplikimi dhe monitorimi i planit;
5. Ndërgjegjësimi/pjesëmarrja

Plani i ri i propozuar për Xhenovën ka objektiva të rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve specifike të territorit siç janë nga reduktimi i mbetjeve, menaxhimi ekonomik dhe mjedisor i qëndrueshëm, monetarizimi i mbetjeve të riciklueshme dhe të rikuperueshme përmes grumbullimit të diferencuar, duke synuar ekonominë e gjelbër deri në përfundimin e ciklit të mbetjeve. Për çdo objektiv janë përcaktuar masa konkrete për t'u ndërmarrë dhe afate kohore të cilat do të monitorohen periodikisht.

Tab. nr. 29 Objektivat dhe indikatorët e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Xhenova

Objektivat	Masat	Indikatorët	Vlerat në 2013	Vlerat në 2018
<b>Objektivi 1</b> Nxitja dhe zhvillimi i parandalimit	Masa 1: Promovimi dhe zhvillimi i Prokurimeve Publike të Gjelbra	Gjenerimi i mbetjeve të ngurta urbane	325.69 kt/vit	Për t'u përcaktuar
	Masa 2: Zhvillimi i kompostimit të brendshëm			
	Masa 3: Veprime për reduktimin e llojeve specifike të mbetjeve			
	Masa 4: Iniciativa për përhapjen e kulturës së parandalimit të mbetjeve			

<sup>59</sup> <https://www.witpress.com/Secure/elibrary/papers/SC15/SC15034FU1.pdf> The definition of an Urban Waste Management Plan: the case of Genoa

<b>Objektivi 2</b> Grumbullimi i diferencuar në 65 %	Masa 1: Rritja e grumbullimit të diferencuar Masa 2: Rritja e ishujve ekologjike Masa 3: Rritja e ndërgjegjësimit ndaj mbetjeve plastike Masa 4: Rritja e grumbullimit të mbetjeve organike	Përqindja e grumbullimit të diferencuar	34.3 %	65 %
<b>Objektivi 3</b> Rikuperimi i mbetjeve në 50 deri në 2020	Masa 1: Rritja me 50 % të sasisë të ripërdorimit, rikuperimit dhe riciklimit	Sasia që synohet të rikuperohet	60.66 ton alumin, letër, dru, plastikë dhe qelq	70 %
<b>Objektivi 4</b> Rikuperimi me teknologji të tjera	Masa 1: Përgatitja e një impianti “ <i>bio-digestion</i> ”	Sasia e energjisë së përfituar	66 milion kWh/vit	Për t’u përcaktuar
		Mbetjet bashkiake të bio degradueshme të dërguara në lëndfill	55,000 – 65,000 ton në vit	Për t’u përcaktuar
<b>Objektivi 5</b> Arritja e autonomisë në menaxhimin e mbetjeve të pa diferencuara	Masa 1: Zhvillimi i një impianti të ndarjes “të thata-të njoma” Masa 2: Rikuperimi i “fraksioneve të thata”	Vetëmjaftueshmëria dhe vënia në punë e impianteve	Jo	Adaptimi i impianteve

Burimi: The definition of an Urban Waste Management Plan: the case of Genoa

### **Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Korçë (2023-2028) nuk ka objektiva konkrete dhe të qarta.**

Duke ju referuar studimit të mësipërm, u shqyrtua në mënyrë më të detajuar Plani i Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Korçë dhe atij të Vlorës të miratuar të dy në vitin 2023. Për këtë në vijim janë gjeneruar gjetje dhe rekomandime me qëllim përmirësimin e planeve të tilla në të ardhmen jo vetëm nga Bashkia e Korçës por edhe nga bashkitë e tjera.

Në rastin e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Korçë nuk ka objektiva të qartë lidhur me reduktimin e mbetjeve që shkojnë në lëndfill, përqindjen e synuar të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, si dhe afate kohore të qarta për të bërë të mundur matjen reale nëse këto objektiva janë arritur apo jo. Krahas saj nuk parashkohet në asnjë paragraf të tij komunikimi si dhe pjesëmarrja e publikut lidhur me synimet e Bashkisë së Korçës sa i përket masave si dhe treguesve të matshëm që duhen marrë me qëllim parandalimin, reduktimin, grumbullimin e diferencuar të mbetjeve etj. Një tjetër aspekt i pa trajtuar dhe i pa specifikuar në Planin e Menaxhimit të Mbetjeve urbane të Bashkisë Korçë është edhe monitorimi. Nuk specifikohet struktura e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe ecurinë e planit, afatet e monitorimit të tij etj. Ky plan fokusohet kryesisht në përshkrimin e situatës ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve nga pikat e grumbullimit (kazanët e mbetjeve) dhe transportimin e tyre për në lëndfill duke marrë më tepër trajtën e një plani operacional se sa një plani të mirëfilltë të menaxhimit të mbetjeve urbane.

Sa i përket Planit të Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkisë Vlorë në tërësinë e tij nuk vihen re këto problematika të cituara në rastin e planit të Bashkisë Korçë sa i përket përmbajtjes së tij. Për mos t’u përsëritur, Plani i Bashkisë Vlorë është i shoqëruar me objektiva specifike e të matshme siç tregohet edhe në Matricën nr. 5. të tij (fq. 148-156). Megjithatë, pavarësisht shumë objektivave të vendosura në këtë plan, nevojitet shumë për t’u bërë nga ana e Bashkisë Vlorë me qëllim monitorimin e ecurisë së zbatimit të tij.

### **Bashkia Shkodër nuk ka arritur të realizojë objektivat kryesore të PVMIM lidhur me minimizimin me 30 % të mbetjeve që shkojnë në Lëndfill**

Plani i menaxhimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Shkodër i miratuar në vitin 2017 është trajtuar më vete për të parë jo vetëm qartësinë e objektivave por edhe realizimin e tyre duke qenë se përkon

me një periudhë të mëparshme. Për këtë arsye grupi i auditimit ka evidentuar disa prej objektivave kryesore të vendosura nga Bashkia Shkodër për të parë se sa ato janë arritur. Kështu, Bashkia Shkodër kishte vendosur minimizimin e mbetjeve urbane që shkojnë në lëndfill me 30% gjatë periudhës 2017-2022 duke:

- Promovuar ndarjen në dy rryma të mbetjeve urbane (të thata dhe të njoma) në lagjet kryesore të qytetit të Shkodrës e më tej në të gjithë qytetin;
- Promovimi i skemave të kompostimit të mbetjeve në Njësitë Administrative Rrethina dhe Dajç e më tej edhe në njësitë e tjera administrative me karakter rural;

Pra nëse në vitin 2017 sasia e mbetjeve që është depozituar në lëndfillin e Bushatit është 39,461 tonë do të duhej që në vitin 2022 në mënyrë që ky objektivi të ishte arritur, Bashkia Shkodër duhej të kishte depozituar rreth 27,000 tonë. Në të vërtetë, Bashkia Shkodër, në vitin 2022 ka depozituar në Lëndfillin e Bushatit 34,747 tonë duke bërë që ky objektivi të mos arrihej. Një ndër arsyet kryesore që ky objektivi nuk është arritur është sepse siç u theksua edhe më sipër deri më sot në Bashkinë Shkodër ende nuk është arritur ndarja e diferencuar e mbetjeve urbane dhe as kompostimi i tyre.

Një tjetër objektivi i mirë i vendosur nga Bashkia Shkodër (dhe që duhet marrë shembull edhe nga bashkitë e tjera) është edhe ai që vendos kufizime në përdorimin e sistemit bashkiak të grumbullimit të mbetjeve e që lidhet me madhësinë dhe sasinë e mbetjeve veçanërisht nga konsumatorët jo-banorë. Më konkretisht konsumatorët jo-banorë (bizneset) që prodhojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e sasisë që mund të hidhet në një konteiner mbetjesh (zakonisht  $1.1\text{m}^3$ ) nuk lejohen të përdorin sistemin publik të grumbullimit të mbetjeve<sup>60</sup>. Vetë Bashkia duhet të ofrojë mundësi dhe metoda të tjera për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve, në përmbushje të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve, shoqëruar me një sistem të ndryshëm tarifash. Në fakt, Bashkia Shkodër ashtu si edhe bashkitë e tjera subjekt auditimi kanë vendosur vlera të ndryshme sa i përket tarifave të pastrimit për konsumatorët jo banor ose më saktë njësitë e biznesit por në asnjërin prej këtyre bashkive nuk janë marrë masa për grumbullimin e veçuar të mbetjeve për këtë kategori. Ajo që ndodh në jo pak raste është se konteinerët e grumbullimit të mbetjeve urbane mbushen me mbetje nga biznese të ndryshme të cilat duke gjeneruar sasi të mëdha të mbetjeve i hedhin edhe jashtë kazanëve duke i hequr mundësinë banorëve të hedhin mbeturinat e tyre në brendësi të konteinerëve. Konkretisht, Bashkia Shkodër pavarësisht se ka vendosur një objektivi të mirë nuk ka arritur ta zbatojë atë duke mos vendosur konteinerë të veçantë për konsumatorët jo banorë të cilët prodhojnë më shumë se  $\frac{1}{4}$  e konteinerëve prej  $1.1\text{ m}^3$ .

### ***Vendgrumbullimi i mbetjeve urbane në qytetin e Vlorës ka efekte negative në shëndetin e popullsisë, mjedis dhe ekonomi.***

Një tjetër çështje e trajtuar nga grupi i auditimit është edhe rehabilitimi i venddepozitimeve të vjetra veçanërisht në Bashkinë Vlorë duke qenë se edhe situata në muajt dhe vitet e fundit ka qenë shumë më problematike. Konkretisht në këtë bashki grupi i auditimit ka vizituar dy venddepozitimet e mbetjeve urbane, atë në Orikum dhe atë pranë qytetit të Vlorës.

Vendgrumbullimi i mbetjeve në qytetin e Vlorës është më i madhi në territorin e bashkisë. Ai gjendet në rrethinat veri-perëndimore të qytetit, në një zonë të përzier me zhvillime kryesisht industriale, por edhe me banesa të reja pranë. Distanca nga ndërtesat e banimit më të afërta është më pak se 50 m. Kështu, era e rëndë dhe tymi janë probleme serioze për banorët. Ngjitur me vendgrumbullimin, kalon një rrëke/përrua nëpërmjet të cilit lëngjet derdhen në det, rreth 1,500 m larg. Hyrja në vendgrumbullim, është e rrethuar me gardh dhe ruhet 24 orë. Përveç zonës së rrethuar të ndarjes, nuk ka struktura të tjera teknike të cilat mund të minimizojnë efektet negative të mbetjeve të hedhura. Për shkak se pjesa tjetër e vendgrumbullimit nuk është e rrethuar, njerëzit dhe kafshët mund të hyjnë lirisht. Në shumicën e rasteve nuk ka struktura apo masa operative për

<sup>60</sup> Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane, 2017-2022 Bashkia Shkodër, fq 55.

reduktimin e emetimeve, që do të thotë se nuk ka menaxhim të ujërave sipërfaqësore, nuk ka sistem bazë izolimi, sistem grumbullimi të lëngut e gazrave që krijohen nga mbetjet. Lëngu i prodhuar nga mbetjet shkakton ndotje të tokës si edhe të ujërave nëntokësore dhe ujërave sipërfaqësore; gazi që çliron vendgrumbullimi përhapet direkt në atmosferë. Për shkak se mbetjet nuk mbulohen me dhe, përbërësit e lehtë merren nga era dhe ndotin zonat fqinje. Dëme të tjera vijnë nga zjarret në fushat e mbetjeve.<sup>61</sup> Edhe gjatë vizitës së grupit të auditimit (foto 8) një pjesë e mbetjeve në fushën e vendgrumbullimit të mbetjeve urbane në qytetin e Vlorës ishin duke u djegur.

Foto 7 & 8. Vendgrumbullimi i mbetjeve në qytetin e Vlorës



Burimi: Grupi i auditimit, mars 2024

Foto 9 & 10. Pamje nga vendgrumbullimi i mbetjeve në Orikum



Burimi: Grupi i auditimit

Vendgrumbullimi i Vlorës është në përdorim që nga fillimi i viteve 1960. Nuk ka sistem të grumbullimit/trajtimit të kullimit ose gazit të lendfillit. Bazuar në hartat topografike dhe vizitën në terren, sasia aktuale e mbetjeve të depozituara në vend vlerësohet të jetë përafërsisht 400,000 m<sup>3</sup>. Rreziqet e këtij venddepozitimi identifikohen si më poshtë:

- Ndotja e ujit të kanalit nga mbetjet dhe rrjedhjet (lidhja e drejtpërdrejtë me detin Adriatik);

<sup>61</sup> Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Vlorë, 2023 – 2028, fq 53,54



- Rrezik për shëndetin për njerëzit që jetojnë në vendbanimet pranë lëndfillit nga degazimi i pakontrolluar i lëndfillit, i cili mund të shkaktojë shpërthime ose ekspozim ndaj gazeve kancerogjene;
- Rreziqet shëndetësore nga parazitët (minjtë, mizat dhe mushkonjat) që shkaktojnë sëmundje infektive;
- Rreziqet higjienike nga kafshët e fermës që kullosin në lëndfill duke shkaktuar rreziqe shëndetësore për kafshët dhe konsumatorët.<sup>62</sup>

### Fact box

Djegia e mbeturinave në mjedis të hapur paraqet rreziqe shëndetësore veçanërisht tek njerëzit me sisteme të ndjeshme të frymëmarrjes, si dhe fëmijët dhe të moshuarit. Në periudhë afat të shkurtër, ekspozimi ndaj tymit mund të shkaktojë dhimbje koke, vjellje dhe skuqje. Ndërsa në periudhë afat gjatë siç është edhe rasti i Vlorës, mund të rrisë rrezikun e zhvillimit të sëmundjeve të zemrës. Disa nga ndotësit kryesorë që rezultojnë nga djegia e hapur e mbeturinave janë:

- Dioksinat;
- Furanet;
- Arseniku;
- Merkurit;
- Plumbi;
- Monoksid karboni;
- Oksidet e azotit;
- Oksidet e sulfurit;
- Acid hidroklorik.

Një nga shqetësimet më të mëdha me djegien e mbeturinave në mjedis të hapur janë rreziqet shëndetësore që vijnë nga çlirimi i dioksinave dhe furaneve në mjedis. Ekspozimi ndaj dioksinave dhe furaneve shkakton:

- Lloje të caktuara të kancerit;
- Probleme të mëlçisë;
- Dëmtime të sistemit imunitar, sistemit endokrin dhe funksioneve riprodhuese;
- Efekte negative në zhvillimin e sistemit nervor.

Ekziston një shqetësim i veçantë për nivelet e larta të dioksinave dhe furaneve që gjenden në kulturat bujqësore të mbjellat, si dhe në mjediset ujore (lumenj, liqene e dete). Dioksinat dhe furanet e prodhuara nga djegia e mbeturinave në mjedis të hapur depozitohen në bimë, të cilat hahen nga kafshët. Dioksinat dhe furanet absorbohen nga këto kafshë dhe qëndrojnë në zinxhirin ushqimor derisa përfundimisht përfundojnë në mishin dhe produktet tona të qumështit.<sup>63</sup>

Krahas këtyre rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore ky vendgrumbullim i mbetjeve ndikon edhe në ekonomi si rezultat i gjenerimit të eksternaliteteve mjedisore ose ndryshe kosto të jashtme mjedisore të cilat lindin kur aktivitetet shoqërore apo ekonomike të një aktiviteti kanë ndikim në komunitet dhe kur aktiviteti nuk arrin llogarisë plotësisht ndikimin e tyre.<sup>64</sup> Pra, edhe në rastin e venddepozitimeve të Vlorës pavarësisht se pranohet në dokumente politike zyrtare që ky vendgrumbullim ka efekte negative në mjedis, shëndet etj., nuk dihet me saktësi cili është ndikimi i vërtetë i tyre në aspektin monetar për komunitetin që jeton aty pranë. Për aspekte të tilla me ndikim direkt ekonomik në komunitet flitet shumë pak veçanërisht në dokumentet kombëtare zyrtare. Disavantazhet apo shqetësimet që jep një aktivitet i caktuar në lokacionin ku ai e ushtron këtë aktivitet dhe të cilat shprehen në vlerë monetare njihen ndryshe si *disamenity*. Ndikimet e

<sup>62</sup> Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Vlorë, 2023 – 2028, fq 56, 57.

<sup>63</sup> [https://www.canada.ca/content/dam/eccc/migration/main/gdd-mw/684b44dd-5780-4f73-bc58-a97e31a19edc/com1170\\_open\\_burning\\_brochure\\_e\\_v6\\_for-20web.pdf](https://www.canada.ca/content/dam/eccc/migration/main/gdd-mw/684b44dd-5780-4f73-bc58-a97e31a19edc/com1170_open_burning_brochure_e_v6_for-20web.pdf)

<sup>64</sup> A Study on the Economic Valuation of Environmental Externalities from Landfill Disposal and Incineration of Waste, fq 6.

*disamenity* nga venddepozitimet e mbetjeve urbane lidhen me ekzistencën dhe përbërjen e tyre pasi ato ndryshojnë sasinë dhe llojin e mbetjeve të cilat përpunojnë. Termi *disamenity* përfshin ndikime të tilla që vijnë nga zhurma, pluhuri, mbeturinat, erë e pakëndshme, prania e parazitëve, pamje vizuale dhe perceptimin e rrezikut për shëndetin e njeriut për të gjitha rreziqet e përshkruara edhe më sipër. Çdo ndikim i *disamenity* ndikon në përcaktimin e vlerës së pronave të cilat ndodhen aty pranë, ose në përlllogaritjen e vlerës si pasojë e efekteve shëndetësore që shkaktojnë ndotësit e ajrit etj. Një ndër studimet më të rëndësishme sa i përket kostove të *disamenity* është ai i udhëhequr nga ekonometristë të Universitetit Cambridge etj., i cili vlerësonte efektin në çmimet e shtëpive rreth lëndfillit apo vendgrumbullimeve të mbetjeve. Në përfundim, gjetjet treguan se sa më e afërt distanca midis shtëpive dhe lëndfillit aq më e lartë ishte zhvlerësimi i këtyre shtëpive. Më konkretisht, për distancat brenda rrezes deri në 400 m afërsi me lëndfillin zhvlerësimi ishte tre herë më i madh se në distancat 400-800 m.<sup>65</sup> Edhe në rastin e shtëpive të cilat ndodhen disa dhjetëra metra deri në disa qindra metra në afërsi me venddepozitimet e mbetjeve urbane të Bashkisë Vlorë është e sigurt që vlera e tyre është disa herë më e ulët se shtëpi të tjera në zona më të pastra të qytetit.

Megjithatë, pavarësisht kësaj situatë, rehabilitimi i këtyre dy venddepozitimeve është parashikuar dhe është pjesë e projektit të Lëndfillit të Vlorës (Sherishtes) dhe konkretisht komponenti i tretë i këtij projekti. Ai përfshin edhe rehabilitimin e dy fushave të mbetjeve, Vlorë dhe Orikum, si dhe 6 pikave të tjera, të cilat janë përdorur për grumbullim mbetjesh në njësitë administrative të Vlorës. Kjo do të thotë, kapsulim i mbetjeve dhe shndërrimi i gjithë zonës përkatëse në një mjedis të gjelbër me lulishte dhe pemë. Lëndfilli i Vlorës ose Sherishtes sic quhet ndryshe ka nisur në Qershor 2020 dhe pritej të përfundonte në Dhjetor 2021. Nga përgjigjet zyrtare të Bashkisë Vlorë theksohet se “Në Mars 2022 me vendim Nr. 134, datë 28.03.2022 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” ndaj Shoqërisë Tregtare “Integrated Technology Services” SHPK është vendosur masa e sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive” si dhe në bazë të ligjit nr. 34/2019 “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara” është caktuar Administrator Shtetëror i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK) për vazhdimin e punimeve dhe dorëzimin e objektit. Administratori Shtetëror ka dështuar në vazhdimin e zbatimit të kontratës dhe si rrjedhojë puna në terren është ndalur. Shoqëria kishte probleme me kryerjen e pagesave pasi detyrimet e palikuiduara ndaj palëve të treta janë kthyer në tituj ekzekutiv, për këtë arsye shoqërisë i janë bllokuar llogaritë bankare nga përmbaruesit privat për këto arsye bashkia Vlorë bazuar në kërkesën e supervizorit në Tetor 2023 ndërpreu kontratën me shoqërinë “ITS”.<sup>66</sup> Pra, si përfundim mund të themi që dy venddepozitimet e vjetra kryesore të mbetjeve urbane ai i Vlorës dhe Orikumit do të fillojnë të rehabilitohen sapo Lëndfilli i Sherishtes të jetë në funksion.

### **Gjetje nga auditimi 1:**

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane të Bashkisë Korçë i miratuar në vitin 2023 nuk ka të përcaktuar objektiva të qartë e të matshëm pasi nuk është shoqëruar me indikatorë apo tregues për matjen e tyre. Konkretisht ky plan nuk vendos objektiva specifike mbi përqindjen e synuar të reduktimit, ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve urbane si dhe nuk mbulon komunikimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, monitorimin e ecurisë së tij. Ai trajton vetëm aspektin operacional të kryerjes së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve duke anashkaluar kështu objektiva apo synime që duhen arritur në periudhën e tij të mbulimit.

### **Gjetje nga auditimi 2:**

Bashkia Shkodër nuk ka arritur të zbatojë objektivin e përcaktuar në Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane 2017-2022 lidhur me minimizimin me 30 % të mbetjeve që shkojnë në Lëndfillin e Bushatit në vitin 2022 krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2017 Bashkia Shkodër ka

<sup>65</sup> Valuation of the external costs and benefits to health and environment of waste management options, fq 45.

<sup>66</sup> Përgjigje me email nga Bashkia Vlorë, dt. 22.12.2023

depozituar në Lendfillin e Bushatit 39,461 tonë, ndërsa në vitin 2022 ka depozituar 34,748 tonë. Objektivi me minimizimin e 30 % të sasisë së mbetjeve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2017 do të thotë që sasia e mbetjeve të depozituara në vitin 2022 do të duhej të ishte reduktuar në rreth 27,000 tonë.

### **Gjetje nga auditimi 3:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë e Vlorë nuk aplikojnë konteinerë të veçuar për konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit prej 1.1 m<sup>3</sup>. Një ndër arsyt kryesore që konteinerë të caktuar mbushen me shpejtësi në momente të caktuara është se konsumatorët jo banorë (bizneset) i hedhin mbetjet e tyre në konteinerët e destinuar për të mbledhur mbetjet familjare.

### **Gjetje nga auditimi 4:**

Djegia e mbeturinave në mjedis të hapur, sikurse po ndodh prej vitesh në qytetin e Vlorë, emeton në ajër elementë shumë të dëmshëm dhe kancerogjenë për shëndetin e njeriut si për shembull dioksina, furane, arsenik, merkur, plumb etj. Ekspozimi i gjatë ndaj këtyre elementëve shkakton lloje të ndryshme kanceri, probleme në mëlçi, dëmtime të sistemit imunitar, endokrin dhe riprodhues pa përjashtuar këtu edhe efekte negative në zhvillimin e sistemit nervor. Në veçanti, dioksinat dhe furanet e prodhuara nga djegia e mbetjeve në mjedis të hapur depozitohen te bimët, të cilat konsumohen nga kafshët dhe në fund përfundojnë te njeriu.

### **Konkluzione**

1. Krahas Bashkisë së Korçës e cila nuk ka përcaktuar objektiva të qartë e të matshëm në PVMIM, Bashkia Shkodër nuk ka arritur të realizojë disa prej objektivave kryesore të përcaktuara në planin e saj të menaxhimit të mbetjeve.

#### **1.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Korçë, Shkodër, Durrës në fazën e përgatitjes së planeve të reja vendore të menaxhimit të mbetjeve urbane të specifikojnë qartë me objektiva konkretë e të matshëm sasinë e mbetjeve që do të reduktohen, ripërdoren e riciklohen si dhe të parashikojnë qartë strukturat monitoruese e raportuese. Gjithashtu, këto plane të përfshijnë aktivitete për edukimin, ndërgjegjësimin etj., të publikut për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane.

#### **Gjatë hartimit të Planeve të reja të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane**

#### **2.1 Rekomandimi:**

Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë e Vlorë të identifikojnë të gjithë konsumatorët jo banorë të cilët gjenerojnë mbi  $\frac{1}{4}$  e volumit të konteinerit të konsumatorit banor prej 1.1 m<sup>3</sup> si dhe të vendosin konteinerë të tjerë për ta.

**Në vazhdimësi**

### **5. GRUPI I PUNËS**

1. A. G., *Përgjegjës Grupi*;
2. B. A., *Anëtar*;
3. Xh. Ç., *Anëtare*.

**Drejtori i Departamentit**

**A.Z.**

## ANEKSI I

### Pyetësorët dërguar bashkive subjekt auditimi

#### Pyetësor 1 <sup>67</sup>

Të nderuar,

Në kuadër të Auditimit me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”, mbi të cilin Bashkia Vlorë është informuar me shkresën nr. prot. 969/3 datë 02.11.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, lutemi të na vini në dispozicion materialet si më poshtë:

- Të vihet në dispozicion në formë tabelare, buxheti i plotë i Bashkisë Vlorë dhe veçanërisht pasqyra e analizës buxhetore ose buxheti analitik i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane. Këto të dhëna të paraqiten me vlerën e planifikimit, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, planin final dhe realizimi. Gjithashtu, të përcillet Projekt Buxheti Afatmesëm (PBA-të) për vitet buxhetore 2020-2023;
- Investime, donacione dhe/ose çdo përfitim tjetër monetar të përfituar nga menaxhimi i mbetjeve urbane për periudhën 2020-2023;
- Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë Vlorë si dhe struktura organike;
- Akte ligjore e nënligjore që lidhen me fushën e auditimit, strategji institucionale, strategji dhe regjistër risku, relacione, vendime, udhëzime dhe raporte të auditimit të brendshëm dhe të institucioneve të jashtme si KLSH, Kryeministria etj. (nëse ka patur), që lidhen veçanërisht me temën e auditimit;
- Plani Lokal (i miratuar) i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane për Bashkinë Vlorë;
- Raporte, studime, analiza, monitorime ose studime që lidhen me temën e auditimit.

Nëse mendoni se të dhëna specifike mund të na ndihmojnë për njohje ndaj institucionit tuaj, me fokus menaxhimin e mbetjeve urbane, që nuk janë përfshirë në pyetësorin njohës, jeni të lirë t’i paraqisni sipas mundësive tuaja.

Ju faleminderit.

*Shënim:* Ju lutemi, kujdesuni që informacioni të përcillet brenda afateve zyrtare (**një javë kalendarike**) të përcaktuara në ligjin nr. 154/12 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kreu 2, neni 15, pika dh, e. Për mbarëvajtjen e auditimit lutemi që të dhënat e mësipërme t’i paraqiten grupit të auditimit në formë elektronike (adresë e-maili: [aguri@klsh.org.al](mailto:aguri@klsh.org.al); [barizaj@klsh.org.al](mailto:barizaj@klsh.org.al); [xhcelaj@klsh.org.al](mailto:xhcelaj@klsh.org.al); brenda dt. 05.12.2023.

#### Grupi i auditimit

1. A.G. (Përgjegjës Grupi)
2. B. A. (Anëtar)
3. Xh. C. (Anëtare)

<sup>67</sup> Ky pyetësor i është dërguar të gjitha bashkive subjekt auditimi.

## Pyetësor 2<sup>68</sup>

Të nderuar,

Në kuadër të Auditimit me temë “Respektimi i standardeve në menaxhimin e mbetjeve urbane, sfidë e qëndrueshme, në zvogëlimin e ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të popullsisë”, mbi të cilin Bashkia Shkodër është informuar me shkresën nr. prot. 969 datë 02.11.2023 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, lutemi të na vini në dispozicion materialet si më poshtë:

### A. Pyetje mbi bazën ligjore/nënligjore

1. Duke qenë se Plani Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane (PLMIMU) për Bashkinë Shkodër ka patur në fokus periudhën 2017-2022, a është menduar nga Bashkia Shkodër marrja e masave për realizimin e një plani të ri?
2. Kush është Sektori/Drejtorja përgjegjëse për monitorimin e ecurisë së zbatimit të Planit Lokal të MMU në Bashkinë Shkodër?
3. A ka raportuar Bashkia Shkodër në Këshillin e Qarkut për zbatimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve për vitet 2020, 2021 dhe 2022? Nëse po vendosni në dispozicion Raportimet zyrtare.
4. A është shoqëruar Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane (2017-2022) me Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)? Nëse po, vendosni në dispozicion VSM përkatëse.
5. A janë miratuar me VKB sanksionet ndaj shkelësve të ndryshëm në fushën e menaxhimit të mbetjeve? Nëse po, cila është struktura përgjegjëse në Bashkinë Shkodër për marrjen e masave dhe vendosjen e sanksioneve?
6. Cfarë sanksionesh janë vendosur nga struktura përkatëse lidhur me shkelje të ndryshme përgjatë viteve 2020, 2021, 202 dhe 2023.

### B. Pyetje mbi procesin e menaxhimit të mbetjeve urbane

1. Sa është sipërfaqja totale e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Shkodër? Sa pika grumbullimi dhe sa konteinerë (me çfarë kapaciteti) janë gjithsej?
2. Listoni të gjitha mjetet teknologjike (makina, kamionë, kapaciteti i tyre etj) që mbulojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve urbane për vitet 2021, 2022 dhe 2023?
3. A grumbullohen në mënyrë të diferencuar mbetjet urbane? Nëse po për cilat rryma, kur ka nisur dhe si kryhet ky proces?
4. A kryhet në Bashkinë Shkodër grumbullimi dhe trajtimi i diferencuar i mbetjeve bio (organike) për qëllim kompostimi? Nëse po, përshkruani procesin.
5. A kryhet në Bashkinë Shkodër riciklimi i mbetjeve urbane të riciklueshme? Nëse po, përshkruani procesin.
6. Përgjatë periudhës 2020-2023 a janë peshuar mbetjet që janë depozituar nga Bashkia Shkodër në Landfillin e Bushatit? Cfarë dokumentash mbahen pas peshimit të tyre nga ana e Bashkise Shkodër?

### C. Pyetje mbi të dhëna statistikore

1. A ka të dhëna Bashkia Shkodër mbi sasinë e mbetjeve urbane të gjeneruara sipas llojit të tyre (plastikë, letër, qelq, metal, organike etj)? Nëse po, ndërtoni një tabelë me volumin dhe përqindjen e mbetjeve të gjeneruara për secilin lloj për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023.
2. A ka të dhëna Bashkia Shkodër mbi sasinë e ricikluar të rrymave letër/karton, plastikë, qelq, metal në vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023?

---

<sup>68</sup> Ky pyetësor (me ndryshime shumë të vogla) i është dërguar të gjitha bashkive subjekt auditimi

3. A ka të dhëna Bashkia Shkodër për sasinë mbetjeve urbane të gjeneruara në vitin 2014 për rrymat letër/karton, plastikë, qelq, metal?
4. A ekzistojnë kompani riciklimi dhe **kompostimi** në Shkoder?
5. A janë bërë aplikime për fonde, donacione, investime etj., nga ana e Bashkisë për të mbështetur nisma dhe biznese të tilla ?
6. Ju lutem plotësoni tabelën “Indikatorët e Performancës Shkodër” të dërguar nga ju në emailin e datës 20.11.2023 edhe për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

#### **D. Pyetje mbi tarifat e pastrimit**

1. Si është parashikuar tarifa e pastrimit për familjet që janë të regjistruar në Regjistrin e Gjendjes Civile (kanë kontratë me UK Shkodër) por nuk banojnë në këtë Bashki? A janë të detyruar të paguajnë dhe a paguajnë këto familje (që kanë kontratë me UK por nuk banojnë aty)?
2. A është transferuar e gjithë vlera e mbledhur e tarifës së pastrimit të mbledhur nga UK Shkodër në Bashkinë Shkodër për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023? Specifikoni diferencat (nëse ka) midis vlerës së arkëtuar nga UK Shkodër dhe asaj të transferuar në Bashkinë Shkodër.

Ju faleminderit.

*Shënim:* Ju lutemi, kujdesuni që informacioni të përcillet brenda afateve zyrtare (**një javë kalendarike**) të përcaktuara në ligjin nr. 154/12 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kreu 2, neni 15, pika dh, e. Për mbarëvajtjen e auditimit lutemi që të dhënat e mësipërme t’i paraqiten grupit të auditimit në formë elektronike (adresë e-maili: [aguri@klsh.org.al](mailto:aguri@klsh.org.al); [barizaj@klsh.org.al](mailto:barizaj@klsh.org.al); [xhcelaj@klsh.org.al](mailto:xhcelaj@klsh.org.al) brenda dt. **19.01.2024**.

#### **Grupi i auditimit**

1. A. G. (Përgjegjës Grupi)
2. B.A. (Anëtar)
3. Xh. C. (Anëtare)